# GAZETA SHQIPTARE








Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7638 E shtunë 1 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)







Opinioni i Ditës

Nga EKREM SPAHIU

## Shpallja e Monarkisë domosdoshmëri kombëtare dhe e ligjshme

Këtu e 90 vjet më parë, pikërisht me 1 shtator 1928, ora 09:12, Asambleja Kushtetuese në mbledhjen e saj të katërt me vota unanime miratoi ...

Vijon në faqet 20-21





Opinioni i Ditës

Nga ZËRI I AMERIKËS

## Diskutimet për shkëmbim territoresh janë të gabuara

Gjermania tërhoqi vërejtjen të premten se ri vizatimi i kufijve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mund të nxisë tensionet etnike. Në hapje të takimit ndërmjet ...

Vijon në faqen 22



Gjykata Kushtetuese: Ndëshkim autorëve

# Polici-prokurori: Grup i posaçëm për hetimin e atentatit ndaj Klodiana Lalës

Lulzim Basha: Gazetarja e "News 24" denoncoi aferën e deputetit të PS. Solidarizohet politika

Një ditë pasi banesa e prindërve të gazetares së 'News24', Klodiana Lala është qëlluar me breshëri kallashnikovi nga persona ende të paidentifikuar, ka reaguar policia dhe prokuroria e Tiranës. Përmes një deklarate të përbashkët, këto dy institucione bëjnë me dije se është ngritur një grup i posaçëm hetimor me ekspertë të Drejtorisë ..

Në faqet 2-3

TRANSPORTI RRUGOR: ZGJIDHET NGERÇI ME LEJET E DREJTIMIT TE AUTOMJETEVE

# PATENTAT E REJA, SHOFERET QE E KANE GATI KARTONIN

Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor publikon listën e personave që kanë gati autorizimin. Ja kush e kalon kursin e teorisë dhe praktikës



(Në foto) Leje drejtimi

Në faqet 9-11

OPOZITA E BASHKUAR

## Lulzim Basha dhe Kryemadhi: S'mund të ketë zgjedhje me Ramën kryeministër

Në faqen 4

"BENI REFLEKTIME"

## Zgjedhjet, Rama kryebashkiakëve: Mund të mos jeni në fushatën e re

Në faqen 5

VITI I SKENDERBEUT

## Hapet ekspozita, 7 shpërnguljet e shqiptarëve ndër shekuj

Në faqen 12

"BLUETOOTH"



## Oriola ndez rrjetin për "fotoshopin". Misteri, Elvana shfaqet me unazë

Suplement

Dëshmia tronditëse/ Albert Doko akuzon spitalin e Durrësit: Ishte me baltë

# "Motra më vdiq, mjekët nuk e prekën me dorë"

*56-vjeçarja Ervehe Dedej gëlltiti një sasi medikamentesh e ndërroi jetë*

Nga KLODIANA HAXHIAJ

DURRES-Mjekët e spitalit të Durrësit janë vënë serish në shënjestrën e denoncimit për neglizhencë. Këtë radhë janë mjekët e urgjencës, të cilët janë akuzuar nga një qytetar që pretendon se blu-






zat e bardha nuk kanë kryer misionin e tyre dhe për pasojë motra e tij ka ndërruar jetë në duart e tyre. Albert Doko thotë se motra e tij 56-vjeçare, Ervehe Dedej kishte shkuar në urgjence pasi kishte kapërdirë një sasi medikamentesh ...

Në faqen 6

EMRAT EDHE PER SARANDEN

## ALUIZNI: 250 emrat që kanë gati lejen e legalizimit në Gjirokastër

Në faqen 8

# SULMI NDAJ GAZETARES
## REAGIMET



### Kreu i PD: Marku kukull në dorë të Ramës, s'firmos arrestimin e deputetit të PS-së

# Sulmi, Basha: I paprecedent, Lala denoncoi aferën "Çyrbja"

### *Kryemadhi: Kriminelët kanë mbështetje qeveritare*

Valentina Madani

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha e quajti dje të pa precedent sulmin me armë ndaj gazetares Klodiana Lala, ndërsa akuzoi prokurorinë se është kthyer në kukull të Edi Ramës. Kjo është arsyeja, sipas tij, që prokuroria nuk sjell në Kuvend kërkesën për arrestimin e deputetit socialist Jurgis Çyrbja, duke e akuzuar si anëtar i organizatës kriminale të Emiljano Shullazit. Denoncimi i kësaj lidhjeje kriminale, shprehet Basha, fshihet dhe pas sulmit me automatik drejt banesës së prindërve të gazetares Klodiana Lala më 30 gusht 2018. "Akti i fundit i kësaj gazetareje ishte denoncimi i aferës Çyrbja. I përgjimeve që tregojnë se deputeti i PS-së i qarkut të Durrësit, Jurges Çyrbja komunikon në telefon me anëtar të bandës së Shullazit duke iu referuar si ne. Është e papranueshme që sot e kësaj dite prokuroria nuk ka asnjë reagim për komunikimet e përgjuara në mënyrë të ligjshme dhe arsyet e mos veprimit të prokurorisë. Nëse kukullat e Edi Ramës në prokurori, ky i fundit do i lejonte të zbatonte ligji në kuvend duhej të kishte mbërritur kërkesa për arrestimin e Jurges Cyrbes anëtar i organizatës kriminale të Emiljano Shullazit. E thotë ai vetë "ne". Mos kujtoni se organizatat kriminale e kanë anëtarësinë me tesera apo bordero. Asnjë kërkesë e tillë nuk ka mbërritur dhe nuk ka si të mbërrijë pasi prokuroria është skllave shërbëtore e Edi Ramës. Dhe ja ku kemi pasojat, krimi e kupton syshkeljen nga shteti. Nuk ka nevojë ta marrë në telefon Edi Rama e ti çojë mesazhe, mjafton syshkelja e krimi të marrë armën e të qëllojë drejt tyre",-deklaroi z.Basha. Kryetari i opozitës veçoi gjatë takimit me gazetarët edhe skandalin më të fundit të qeverisë: kërcënimin bërë gjyqtarit shqiptar në Strasburg, Ledi Bianku. "Skandali që shpërtheu para disa ditësh me gjykatësin në Strasburg tregon sesi Edi Rama kontrollon sistemin e drejtësisë dhe vetingun. Kur dërgohen emisarët e Ramës në Strasburg që të kërcënohet dhe joshet gjyqtari atje, imagjino se çfarë ndodh këtu! Imagjinoni se çfarë presioni u bëhet atyre komisionerëve të vetingut që nuk vijnë nga paradhoma e Edi Ramës - se ka nga ata që janë kontigjente kriminale, subjekte të ligjit Antimafia, që i ka jo në xhep, por në poture - të tjerëve mendoju se çfarë presioni u bëhet",-tha z.Basha.

**AKUZAT**

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, e konsideron shoqërinë shqiptare të pasigurtë ditët e sotme duke marrë shkas nga sulmi me armë ndaj gazetares Klodiana Lala. E ftuar në rubrikën "Opinion" në studion e lajmeve në 'News24', ajo tha se reforma për drejtësi nuk po ecën si duhet, dhe prandaj sot kriminelët kanë aq guxim sa të qëllojnë me armë mbi gazetarët. "S'do bëj as rolin e prokurorit as polices, por dua të prek mënyrën si merren institucionet me ngjarjen. Nga ana tjetër' thuhet që reforma në drejtësi u ngjalli frikën kriminelëve, ça frike? Kujt kriminelë? Shikoni si sulmohet gazetarja. Kemi dhe një lloj indiference, më shpejt reaguan ndërkombëtarët, se institucionet tona. Është e rëndë trimëria dhe guximi që gjejnë për të goditur mbi një shtëpi, se të frikëson. Duke qenë gazetare e kronikës së zezë është në kontakt me policinë e prokurorinë. Edhe pak bëhen gati 48 orë dhe asgjë s'është zbuluar. Këta njerëz që sulmojnë kanë përkrahje të madhe që e bëjnë këtë veprim. Këtu po arrestohen dy persona se zihen për fjalë goje, ndërsa këta qëllojnë me armë nuk kapen. Nëse nuk do ketë një ndalim të shkaktarëve të kësaj, atëherë do të ndodhin shumë, siç kanë ndodhur për ngjarje që ende nuk janë zbardhur. Shoqëria s'është e sigurtë",- tha Kryemadhi. Teksa iu referua për herë të dytë sulmit me armë ndaj banesës së prindërve të gazetares Klodiana Lala, kryetarja e LSI Monika Kryemadhi tha se "kriminelët nuk kanë se si të frikësohen nga ligji, kur në krye të shtetit është një kryekriminel".

**LULZIM BASHA**

"Nga Ardian Dvorani tek Dritan Halluni me shokë. Të paktën 11 të tillë, gjyqtarë dhe prokurorë, që qartësisht dhe nga raportet e vetingut, dukshëm nuk plotësojnë kriteret e figurës, por i duhen Edi Ramës për të mbrojtur vjedhjet e Edi Ramës dhe kontingjentin kriminal",-tha z.Basha.



**MONIKA KRYEMADHI**

"Edhe pak bëhen gati 48 orë dhe asgjë s'është zbuluar. Këta njerëz që sulmojnë kanë përkrahje të madhe që e bëjnë këtë veprim. Këtu po arrestohen dy persona se zihen për fjalë goje, ndërsa këta qëllojnë me armë e nuk kapen",-tha zj.Kryemadhi.

## Kercenimi



**SONILA QATO**

Ministrja për Mbrojtjen e Sipërmarrjes Sociale, Sonila Qato dënoi sulmin me armë zjarri ndaj banesës së prindërve të gazetares Klodiana Lala. "Ne nuk do lejojmë që fenomene të tilla të ndodhin më. Kam bindjen që ky nuk është një moment ndasie apo urrejtje mes nesh, por një solidaritet dhe unitet i gjithë shoqërisë. Kam informacion se ka një impenjim maksimal të strukturave për të zbardhur këtë ngjarje të rëndë"- tha Qato.

### Sulmi me armë ndaj banesës së gazetares

## 'Lala', Gjykata Kushtetuese: Të zbulohen dhe ndëshkohen autorët e krimit

Gjykata Kushtetuese dënoi dje sulmin me armë ndaj banesës së prindërve të gazetares së 'News24', Klodiana Lala. Gjykata Kushtetuese shprehet se inkurajon organet e hetimit për të zbuluar dhe ndëshkuar autorët e kësaj ngjarje kriminale. "Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë dënon me forcë sulmin me armë kundër familjes së gazetares Klodiana Lala. Duke mbështetur gazetaren Klodiana Lala dhe median e pavarur në misionin e saj, në të njëjtën kohë inkurajon organet e hetimit të bëjnë



të mundur zbulimin dhe ndëshkimin në një kohë sa më të shpejtë të autorëve të kësaj ngjarjeje të shëmtuar kriminale"- thuhet në reagimin e Gjykatës Kushtetuese. Ngjarja e rëndë është shënuar rreth orës 03:00 mëngjesit të së enjtes, ku persona ende të paidentifikuar kanë qëlluar me breshëri automatiku në drejtim të banesës së babait të gazetares. Plumbat kanë prekur muret e banesës, si edhe kasën e derës së jashtme te saj, ndërsa në vendngjarje janë gjetur 10 gëzhoja kallashnikovi. Në momentin e ngjarjes brenda banesës kanë qenë 8 persona, prindërit, motra, vëllai, të afërm të familjes dhe 2 vajzat e gazetares Lala përkatësisht 2 dhe 5 vjeç. Vetë gazetarja dhe bashkëshorti i saj nuk ndodheshin në banesë. Fatmirësisht nga kjo ngjarje nuk pati të lënduar.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Dossier:** Iv Kaloçi, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli,
***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI. ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpëmdarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



## Klodiana Lala: Unë dhe familja ime nuk kemi probleme me askënd

# Sulmi ndaj gazetares, policia dhe prokuroria: Është ngritur grup i posaçëm hetimor

## *Pista e hetimit: Kërcënim për shkak të detyrës*



**TIRANE**

Një ditë pasi banesa e prindërve të gazetares së 'Neës24', Klodiana Lala është qëlluar me breshëri kallashnikovi nga persona ende të paidentifikuar, ka reaguar policia dhe prokuroria e Tiranës. Përmes një deklarate të përbashkët, këto dy institucione bëjnë me dije se është ngritur një grup i posaçëm hetimor me ekspertë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndonëse ngjarja nuk ka ende autor, policia e dhe prokuroria e Tiranës bëjnë me dije se janë kryer një sërë veprimesh me metoda speciale të hetimit për të bërë të mundur zbardhjen e ngjarjes. Gjithashtu, ditën e djeshme gazetarja Klodiana Lala ka dhënë dëshminë e saj në prokurorinë e Tiranës. Për Lalën sulmi i ndodhur lidhet direkt me punën e saj si gazetare, për shkak të çështjeve që ajo ka investiguar. Gjithashtu, ajo ka sqaruar se ajo dhe familja e saj nuk kanë konflikte me asnjë person dhe sulmi me armë ka vetëm një motiv, atë për shkak të detyrës. Ndërsa prokuroria ka regjistruar një hetim penal për akuzën e vrasjes me dashje e mbetur në tentativë ndaj dy ose me shumë personave si dhe armëmbajtje pa leje. Hetuesit kanë marrë edhe dëshmitë e familjarëve të Klodianës, të cilët i kanë qëndruar versionit që nuk kanë probleme me askënd. Ngjarja e rëndë ndodhi mëngjesin e së enjtes në fshatin Domje të Tiranës, aty ku prej vitesh jeton familja e gazetares së kronikës së zezë, Klodiana Lala. Banesa e prindërve të saj, përjetoi momente terrori, pasi rreth orës 03:00 të mesnatës persona ende të paidentifikuar me breshëri kallashnikovi, banesën e familjes së gazetares Lala.

**DEKLARATA**

Në lidhje me veprimet e kryera për ngjarjen e ndodhur në orët e para të mëngjesit të datës 30 gusht 2018, ku është qëlluar me armë zjarri në drejtim të banesës së shtetasit Arif Lala, i ati i gazetares Klodiana Lala, informojmë se: Në datë 30 gusht 2018, rreth orës 06:40 minuta, Policia e Tiranës u njoftua se në rrugën "Shkëndija", fshati Bruk, Tiranë persona të paidentifikuar kanë qëlluar me armë zjarri në drejtim të banesës së shtetasit Arif Lala. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 03:00 të mëngjesit. Për pasojë është dëmtuar fasada ballore dhe dera hyrëse e banesës. Në momentin e sulmit, në banesë ishin prindërit e gazetares, vëllai, dy fëmijët e gazetares dhe dy miq të afërm të familjes. Personat brenda banesës nuk kanë pësuar dëmtime.

Në lidhje me këtë ngjarje, menjëherë është ngritur një grup i posaçëm hetimor me ekspertë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ana e grupit hetimor janë kryer veprimet procedurale në vendin e ngjarjes si dhe janë kryer një sërë veprimesh me metoda speciale të hetimit për të bërë të mundur zbardhjen e ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorëve. Grupi hetimor po vijon me intensitet maksimal veprimet hetimore dhe procedural, por për arsye hetimi nuk mund të bëjmë me dije të dhëna të tjera.

### MYFTIU I TIRANËS

Myftiu i Tiranës, Ylli Gurra solidarizohet me gazetaren e 'News24', Klodiana Lala. Në një postim në 'Facebook', Myftiu Gurra shkruan se solidarizohet me të drejtën e fjalës. "Me Klodin! Me të drejtën e fjalës dhe të përcjelljes së informacionit për publikun! Me fuqinë e tyre për ta bërë shoqërinë më të mirinformuar! Me sakrificën dhe kurajën e të gjithë gazetarëve të terrenit, veçanërisht atyre të kronikës së zezë! FJALA ESHTE E PARA! Solidar me ty, vajzat dhe prindërit e tu, Klod!"-shkruan Myftiu Gurra.

## Reporterët pa Kufij: Autoritetet kanë për detyrë ta mbrojnë gazetaren

Organizata Ndërkombëtare Reporterët pa Kufij për lirinë e informacionit (Reporters Without Borders) ka reaguar pas sulmit ndaj gazetares së 'Neës24' e 'BalkanWeb', Klodiana Lala. Në një postim në 'Twitter' të organizatës për Europën thuhet se RSF dënon sulmin me kallashnikov ndaj shtëpisë së gazetares Lala, ndërsa shprehet se autoritetet kanë për detyrë ta mbrojnë atë. "RSF dënon sulmin me kallashnikov në shtëpinë e Klodiana Lala, një reportere investigative që mbulon krimin e organizuar në Shqipëri. Autoritetet e kanë për detyrë ta mbrojnë atë dhe të dënojnë sulme të tilla",-thuhet në reagimin e Reporterëve pa Kufij për Europën.



## Pushohen hetimet për dhunën ndaj Fundos, gazetari: Në këtë vend mafia ka kapur çdo gjë

Rreth një vit e gjysmë pas ngjarjes së rëndë, ku gazetari Elvi Fundo u dhunua barbarisht në mes të ditës në Tiranë, organet e drejtësisë mësohet se kanë pushuar hetimet. Prokuroria e Tiranës ka vendosur që të pezullojë hetimin me arsyetimin e moszbulimit të autorëve që e goditën barbarisht. Gazetari investigativ Artan Hoxha ka publikuar në faqen e tij në 'Facebook' dokumentin e prokurorisë që njofton në datë 31 korrik pezullimin e hetimeve 18 muaj nga ngjarja. Më tej në postim Hoxha paralajmëron gazetarin Fundo, se "tani duhet që brenda 10 ditësh të apeloje vendimin në gjykatë ose ndryshe ...t'ia mbathë nga sytë këmbët nga ky vend pasi autorët (këtë radhë edhe më të inatosur se herën e parë) mund të rikthehen serish te mbarojnë atë që nisën mëngjesin e 8 marsit 2017." Ndërkohë ditën e djeshme pas pezullimit të hetimeve ka reaguar edhe vetë gazetari Fundo, duke shkruar në rrjetin e tij social, 'Facebook'.



"Pas dhunës dhe mos zbardhjes së ngjarjes nga policia. Pas mbështetjes nga Basha të segmenteve të krimit dhe drogës që dyshohen për rastin tim. Pas heshtjes të Fatmir Xhafajt dhe mungesës së vullnetit nga qeveria për kapjen e autorëve dhe urdhëruesit. Pas servilizmit të Ramës e Metës ndaj krimit. Pas isos që mbajnë ndaj krimit qerosët dhe beqirat e partive. Pas 18 muaj prokuroria, ashtu siç pritej pezullon hetimet. Përgjegjës policia e prokuroria që i vendosi vulën.

Këtu duhet të të vrasin që të shpresosh të zbardhin ngjarjen e kapin autorët. Levat pas koke apo plumbat në shtëpi si rasti i Klodit nuk vlejnë. Bandat dhe mafia kanë kapur çdo gjë në këtë vend, qeverinë, opozitën, policinë e prokurorinë. Të gjithë janë bashkautorë në krim dhe fshehjen e tij. E në Shqipëri në këtë e quajmë shtet. Konica kishte të drejte, shumë aktuale", shkruan gazetari në 'Facebook'.

ZGJEDHJET LOKALE
PERPLASJA

Kreu i PD: Kryeministri të tërheqë ligjin për Teatrin, ose pasojat deri në përplasje civile

# Basha: Zgjedhje të reja, nuk do ketë më pakt me Ramën

*"Asnjë konsensus me PS, opozita e bashkuar për lokalet"*



Gjatë një seance parlamentare

Valentina Madani

Kreu i opozitës Lulzim Basha paralajmëroi dje një betejë të ashpër brenda dhe jashtë parlamentit kundër qeverisë "Rama". Në një bashkëbisedim me gazetarët Lulzim Basha prerazi deklaroi se prioritet i demokratëve është shkëputja e lidhjeve të qeverisë me krimin. Nga 1 shtatori PD nis punën për t'u bërë gati për betejën elektorale të qershorit 2019. Lideri i opozitës, njoftoi se paralelisht me zgjedhjet në parti do të nisë procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për garën për bashkitë. Por z.Basha mohoi në mënyrë të prerë mundësinë e bashkëpunimit dhe bashkëqeverisjes me socialistët. "Nuk ka asnjë pakt me Partinë Socialiste. Dhe nuk do të ketë asnjë pakt me PS-në reformën zgjedhore, para se ne t'i japim përgjigje dhe zgjidhje politike, katastrofës në të cilën ndodhet vendi dhe para se ne të arrijmë në akord opozitar, me të gjitha forcat politike të opozitës. Gjithçka tjetër është mashtrim, i cili bëhet me qëllim për të intensifikuar thashethemnajat e verës se do të ketë një tjetër pakt Rama-Basha. Nuk do të ketë një pakt tjetër Rama-Basha. Nuk do të ketë bashkëqeverisje PD-PS. Synimi i PD dhe i imi është t'i japim fund një orë e më parë, një qeverie të lidhur me krimin",-deklaroi z.Basha. Nuk përjashton edhe opsionin e zgjedhjeve të parakohshme, krahas procesit elektoral që pritet të nisë në shtator në PD. "PD do nisë përgatitjet për zgjedhjet politike, të imponojmë çdo zgjidhje politike",-u shpreh z.Basha. Vijën e kuqe ia kujtoi sërish Edi Ramës, teksa u ndal tek dekreti i Presidentit Meta për kthimin në parlament për rishqyrtim të ligjit për Teatrin Kombëtar. "Mos i shkojë mendja ta sjellë në seancë ligjin 'Fusha', se do jetë shpallje e konfrontimit fizik dhe asgjësimit civil",- u shpreh Lulzim Basha. Kryetari i demokratëve, njoftoi se në shtator do të nisë procesi i zgjedhjeve në parti, i shtyrë disa muaj më parë. Paralelisht me këtë, tha ai, do të evidentohen edhe kandidatët për zgjedhjet vendore. Basha, la të kuptohet se opozita nuk ka qëllim të bojkotojë zgjedhjet edhe pse akuzon se socialistët të lidhur me krimin kërkojnë të blejnë votat e qytetarëve. "Partia Demokratike do të nisë paralelisht, procesin e zgjedhjeve të brendshme në shtator dhe procesin e identifikimit të kandidatëve për zgjedhjet lokale dhe natyrisht do të përgatitet për zgjidhjet politike, të cilat nuk mund të jenë zgjedhjet lokale", deklaroi kreu i PD-së. Në këtë pikë Basha, për herë të parë dha mesazh të qartë se kandidatët do të jenë të përbashkët me forcat e tjera opozitare, përfshirë LSI-në. "Vullneti im dhe i aleatëve të tjerë, është që natyrisht që opozita do të përballet e bashkuar me të gjitha sfidat, por jo vetëm ne, jo vetëm faktorët politikë, por ne po kërkojmë dhe do të zhvillojmë instrumentet që ky bashkim të jetë sa më i madh i shqiptarëve dhe jo vetëm i faktorëve politikë",-u shpreh kreu i PD-së. Basha nuk dha detaje për sjelljen e opozitës me Kuvendin, por kur flitet për ligjin e Teatrit të ri Kombëtar, ai kishte një thirrje të prerë për socialistët. "Dua t'i përsëris thirrjen time të prerë, të tërhiqet menjëherë pa bërë gëk-mëk. Shansin ia ka dhënë presidenti me kthimin e dekretit e arsyetuar në mënyrë të plotë. Mos t'i shkojë në mendje ta sjellë në seancë! Mos t'i shkojë në mendje ta sjellë në seancë! Sepse ajo do të jetë, siç ju thash edhe më parë, do të jetë një shpallje e konfrontimit dhe përplasjes civile",- deklaroi z.Basha. Lideri i opozitës, foli edhe për çështjen e Kosovës, duke u shprehur kundër idesë për korrigjimin e kufijve. Sipas Bashës një ide e tillë atij i është propozuar nga serbët që në vitin 2010, por sipas tij është anti-Bashkimit Europian dhe NATO-s.



Kreu i PD-së Lulzim Basha dje gjatë bashkëbisedimit me gazetarët

**KANDIDATËT**
Lideri i opozitës, njoftoi se paralelisht me zgjedhjet në parti do të nisë procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për garën për bashkitë. Por z.Basha mohoi në mënyrë të prerë mundësinë e bashkëpunimit dhe bashkëqeverisjes me socialistët.

**REFORMA**
**PAKTI**
"Nuk ka pakt PS-PD për reformën zgjedhore para se t'i japim zgjidhje katastrofës ku e ka çuar vendin qeveria, çdo gjë tjetër është thashethemnajë, s'ka pakt Rama- Basha, s'do ketë bashkëqeverisje PS-PD".



**IMPONIMI**
**OPSIONI**
Basha s'përjashton opsionin e zgjedhjeve të parakohshme, krahas procesit elektoral që pritet të nisë në shtator në PD. "PD do nisë përgatitjet për zgjedhjet politike, të imponojmë çdo zgjidhje politike".



**PROTESTA**
"S'do ndalemi përballë këtij njeriu, me protesta me të gjitha. Të gjitha do i bëjmë, do i mbledhim njerëzit rreth e qark Kuvendit, që të mos futet. Unë si kryetare partie do dal për të sensibilizuar njerëzit. Ky ka për t'i marrë njerëzit shtëpive. Te ish-materniteti do shihni si Rama shembi shtëpitë. Përdor taktikën përça e sundo",-tha Kryemadhi.

## "Ditët e nxehta të politikës nisin në shtator"

### Kryemadhi zbulon skenarin e opozitës: Do rrethojmë Kuvendin

Drejtuesja e LSI-së Monika Kryemadhi paralajmëroi dje ditë të nxehta për politiken këtë vjeshtë, teksa iu referuar projektit të Teatrit Kombëtar, që ajo e cilësoi grabitje e kulturës dhe historisë. Monika Kryemadhi gjatë takimit me anëtarë të LRI-së bëri sërish thirrje për një front kombëtar kundër qeverisë së Edi Ramës. Sipas nr 1 të LSI-së, shteti shqiptar po shkon drejt falimentimit. "Ditët e nxehta të verës nuk kanë mbaruar për politikën shqiptare. Përkundrazi ditët e nxehta nisin në shtator. Shqipëria është në një alarm të madh, dhe një alarmi të madh duhet t'i përgjigjemi me një front të madh kombëtar. Situata ku gjendet sot Shqipëria është një nga situatat më të këqija që ka pasur ndonjëherë. Është në kufijtë e humbjes së identitetit të saj, të rrëzimit të shtetit të saj",-deklaroi Kryemadhi. Dy ditë më parë Kryemadhi njoftoi se PD e LSI do të dalin me një kandidat të përbashkët për Tiranën për të fituar garën. Gjithashtu, opozita e bashkuar po punon për një platformë për të nxjerrë shqiptarët nga kriza. Duke u ndalur në zgjedhjet vendore të vitit të ardhshëm Kryemadhi tha se e gjithë opozita është në një front. 'Diskutohet për një zgjerim të fronit, kundër kësaj të keqeje që ka uzurpuar çdo gjë. Kemi kohë deri te zgjedhjet lokale. E gjithë opozita do jetë bashkë, sepse sot PS është grabitur nga një grup kriminelesh ka ngelur e vetme. Spektri politik po kërkon një rifrymëmarrje', - u shpreh Kryemadhi.


**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

Pasuria nr. 1/165+1-8/1, LLOJI 'APARTAMENT', VOLUMI 6, FAQE 179, SIPËRFAQE 57 M2, ZONA KADASTRALE 8350, TIRANË, NË PRONËSI TË Z. PËLLUMB META DHE ZNJ. RITA META
**ÇMIMI 4.118.696 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 13.09.2018**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866** .

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

PASURIA E LLOJIT 'PYLL + KULLOTË', ME SIPËRFAQE 190.000 M2, ZONA KADASTRALE 3028, ME ADRESË: PORO VLORË, NË PRONËSI TË Z. FATION UKA.
**ÇMIMI 1.824.000 EURO . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 15.09.2018.**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866 .**

**SHPALLJE ANKANDI**
**Datë 06.09.2018, Ora 16:00**
**Shoqëria Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k** me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com.
Shpall ankandin e dytë për pasurinë e paluajtshme të debitorit Luan Zef Pali dhe dorëzanëses Loreta Pjetër Pali:
"Apartament" me sipërfaqe 88.9 m2, nr.i pasurisë 4/162+1-12, zona kadastrale 8631, vol. 6, faqe 20, adresa: Rruga "Gurra", pallati 138, shkalla 1, apartamenti 12, Lezhë.
Çmimi fillestar i ankandit të dytë është në shumën 2 419 984 (dy milionë e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë.



## Kryeministri flet për zgjedhjet në takimin me krerët vendorë dhe ndan detyrat

# Vendoret, Rama-kryebashkiakëve: Mund të mos jeni në fushatë

## "Mos humbni kohë, bëni reflektimet tuaja"



Kryeministri Edi Rama

Kryeministri Edi Rama zhvilloi dje një takim me prefektët dhe kryetarët e bashkive lidhur me sezonin turistik po nuk i ka shpëtuar dot politikës. Ai paralajmëroi kryebashkiakët para zgjedhjeve të 2019-ës që të marrin masa për sezonin turistik duke lënë të kuptohej se nuk do të ishin të gjithë për rikandidim. "Bëni reflektimet tuaja e bëni propozimet pa humbur kohë për sezonin e ardhshëm pavarësisht se qershorin e ardhshëm janë zgjedhjet, e shumë nga ju mund të jenë në fushatë shumë mund të mos jenë, po përgatitjet duhen filluar",-tha Rama. Ai shprehu keqardhje që disa prej kryebashkiakëve demokratë nuk ishin të pranishëm në këtë takim. "S'dua të bëj politikë, por më vjen keq që s'janë të pranishëm kryebashkiakët e PD, ndërkohë që flasim për një temë të përbashkët, s'ka arsye të kemi ndarje politike. Një sipërmarrës në Velipojë më tha si i ishin ulur taksat, por në rrugë s'ishte hedhur asnjë lopatë me rërë. Kjo është kambanë për Bashkinë e Shkodrës. Secili mund të dëgjojë për kambana të tilla në të gjithë territorin. Duke pasur vetëdijen se sa shumë janë nevojat tuaja duhet të shohim bashkërisht mundësinë që të bëjmë ndërhyrje të zgjuara",-tha kryeministri Rama.

**REZULTATET**

Rezultatet pozitive të sezonit turistik të këtij viti kanë bërë që qeveria 'Rama' të zgjedhë si prioritet të zhvillimit ekonomik për vitin e ardhshëm turizmin. Duke folur me shifra konkrete, kreu i qeverisë në një takim të zhvilluar me kryebashkiakët në vend, tha se krahasuar me një vit më parë nga ky sektor kanë hyrë në ekonomi gati gjysmë miliardi euro. Ndonëse një pjesë e kryetarëve të opozitës e kishin shpërfillur ftesën e kryeministrit, Rama u kërkoi të gjithëve pa ndarje politike që të nisin që tani përgatitjet për një sezon sa më të mirë turistik vitin e ardhshëm. Ai vuri në dukje se këtë vit ka rritje të madhe të numrit të turistëve dhe afro gjysmë miliardi euro më shumë të futur në ekonomi nga turizmi se sa vitin e kaluar. Sezoni turistik ende nuk ka përfunduar, por sipas kryeministrit Rama, tani është momenti i duhur për të bërë disa komunikime, për të transmetuar disa konkluzione dhe hedhur bazat për të çuar më tej punën e mirë të nisur. Kryeministri vlerësoi rolin e rëndësishëm të bashkive dhe bashkëpunimin me njësitë e qeverisjes vendore. "Pa asnjë diskutim në pikëpamjen e shifrave dhe të hyrave në ekonomi, ky është një vit që mund të konsiderohet me plot gojën shumë domethënës dhe që përbën një pasqyrë kuptimplotë të asaj që është arritur, por mbi të gjitha asaj që mund të arrihet duke fokusuar përpjekjet tona te turizmi",- deklaroi Edi Rama. Rritja e formalizimit dhe rritja e numrit të shitjeve me kupon, sipas tij, do të thotë edhe më shumë të ardhura për njësitë vendore dhe më shumë investime për to. Rama foli edhe për pastërtinë duke kërkuar të bëhet më shumë në këtë drejtim. Rama u sugjeroi krerëve të bashkive të fokusohen edhe tek festat lokale për t'i kthyer ato në mundësi përfitimi nga fermerët. "Është e udhës që të reflektojmë dhe mbi festat lokale"-tha Rama.

**SALI BERISHA**

Ish-kryeministri Sali Berisha ndan me ndjekësit në 'FB', shqetësimin e madh të një qytetari invalid nga Peqini. Ai i ankohet se është me urdhër mbrojtje për shkak të gruas, por kur shkon në polici, efektivët e rrahin, ndërkohë që gruan ia përdorin si prostitutë.



### "Tani ka një horizont të qartë për ne"

## Bushati në Vjenë: Shqipëria progres në rrugën drejt integrimit

Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati ndodhet në Vjenë në takimin informal të ministrave të Punëve të Jashtme të Bashkimit Evropian. Diskutimet mes ministrave të jashtëm të BE, përfaqësuesve të lartë të Unionit dhe ministrave të jashtëm të vendeve kandidate u përqendruan rreth faktit se, forcimi i multilateralizmit efektiv dhe rendit global të bazuar në rregulla është një nga prioritetet kryesore të Strategjisë Globale të BE-së, dokumenti themelor i strategjisë së BE-së për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, njofton ministria e Jashtme. Ky është në të njëjtën kohë edhe një nga prioritetet e Presidencës Austriake të Këshillit të Bashkimit Evropian. Në fjalën e tij, Ministri Bushati vuri në dukje se, aspiratat e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në BE nuk mundet të jenë të shkëputura nga vlerat dhe synimet që kërkon të arrijë politika e jashtme dhe e sigurisë e Bashkimit Evropian, mbi të gjitha, mbrojtja e një rendi botëror të bazuar mbi rregulla. Bushati theksoi qëndrimin e vazhdueshëm dhe konsistent të Shqipërisë dhe linjëzimin e plotë të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë me BE duke theksuar se kjo politikë i ka rrënjët në vlera dhe norma demokratike që vendet tona po përpiqen të brendësojnë. "Mendoj se kemi bërë një progres të konsiderueshëm gjatë muajve të fundit dhe tani ka një horizont të qartë për Shqipërinë, por edhe për fqinjin tonë. Ka edhe një afat kohor. Kemi filluar procesin screening, i cili do të na japë mundësi të mëdha për transformimin e institucioneve tona dhe për reformat. Pjesëmarrja në "formatin Gymnich" është, gjithashtu, një mundësi e mirë, sepse sot do të diskutojmë për efektet e multilateralizmit, si edhe për mjedisin e sigurisë në rajonin tonë duke pasur parasysh edhe zhvillimet e fundit pas marrëveshjes mes Athinës dhe Shkupit, dialogun mes Kosovës dhe Serbisë dhe ngjarjet e tjera me peshë në rajonin tonë",- tha z.Bushati.


**Njoftim për shitje me ankand**

**Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k** do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e dorezanesin K S te ndodhura ne fshatin Panahore. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga :
"Pasuria "Are" me nr. 206/48 vol. 5 fq 31, me siperfaqe 2500 m2 ZK 2869 me cmim 1.200.000 lekë
"Pasuria "Are" nr.206/7 me vol 4, faqe 244, sipërfaqe 500 m2 ZK 2869, me cmim prej 80.000 lekë
"Pasuria" me nr. 70/15, vol 6, faqe 85 me siperfaqe 51 m2 e ndodhur në zonën Kadastrale 2869 me çmimin në masën 400.665 lekë
**Ankandi eshte progresiv e do të zhvillohet dt 13.09.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishta" Kulla 1,Kati 2, zyra.5. Kont tel. 672082543, e-mailit ilir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com**



giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

**OPEN CALL FOR TENDER**

**PREQUALIFICATION**

**1. GENERAL CONDITIONS**

**1.1. Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1

**1.2. Profile:** German Development Cooperation, Office in Tirana supports Albania on its path to European integration and development through projects implemented in economic development, legal reform, vocational education and training, reform of the water sector, rural development, reforms on strengthening of the internal security, and other areas.

**1.3 Subject:** The GIZ Office Tirana invites qualified companies to express their interest in providing surveillance and technical equipment such as mini-cameras, micro-transmitters, micro audio recorders, etc.

**2 Companies should fulfill the following requirements:**

2.3 The products should be 'brand name' and the company should be an authorized partner for Albania from manufacturer, for selling and supporting the brand(s) products they offer.

2.4 The company should be an authorized service provider for the products it will offer.

All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: giz-albanien@giz.de

3 The **due date** for submitting the application is **10 September 2018**. The application, and any related documents if applicable, should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: Procurement of respective equipment for the project "Stärkung der inneren Sicherheit im Westbalkan"", addressed to:

**German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana, Rr. Skenderbeg, No. 21/1 Tirane**

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.

"Kërkoj hetim për mjekët e urgjencës, do bëj denoncim në polici"

# 56-vjeçarja vdes në spitalin e Durrësit, i vëllai akuzon mjekët: Nuk e prekën për 3 orë

## Albert Dedej: Nuk i afroheshin motrës se ishte bërë me baltë

Klodiana Haxhiaj

**DURRES**

Mjekët e spitalit të Durrësit janë vënë serish në shënjestrën e denoncimit për neglizhencë. Ketë radhë janë mjekët e urgjencës, të cilët janë akuzuar nga një qytetar që pretendon se bluzat e bardha nuk kanë kryer misionin e tyre dhe për pasojë motra e tij ka ndërruar jetë në duart e tyre. Albert Doko thotë se motra e tij 56-vjeçare, Ervehe Dedej kishte shkuar në urgjence pasi kishte kapërdirë një sasi medikamentesh dhe për tre orë me radhë nuk është vizituar nga mjekët. "Motrën nuk e shpëton as Zoti". Kjo sipas Albert Dedej ka qenë përgjigja e një mjekut në urgjencën e spitalit të Durrësit, kur ai çoi motrën në gjendje shumë të rëndë shëndetësore. "E shef motrën më tha mjeku nuk e shpëton as Zoti. I thashë unë e kam sjellë në spital jo tek Zoti, tek Zoti do shkojë kur t'i vijë ora, jo nga spitali. Nuk zgjati as 5 minuta motra ime vdiq. Denoncoj mjekët e urgjencës, thanë nuk kemi çfarë t'i bëjmë", u shpreh Albert Doko. Alberti thotë se motra e tij 56-vjeçarja Ervehe Dedej, u gjet në një kanal në Bisht Pallë, pasi kishte pire një sasi medikamentesh. Vëllai tregon se kur e dërguan në urgjence ishte bërë pis me baltë. Kjo sipas tij mjaftoi që mjekët mos ta preknin me dorë për 3 orë edhe pas lutjeve të nënës së moshuar për ta shpëtuar vajzën. "Është gjetur nga një qytetar e shtrirë. Për orë të tëra motrës nuk i është dhënë asnjë shërbim. Asnjë mjek nuk i afrohej, ajo ishte bërë shumë pis dhe nuk e preknin me dorë. Kur shkoj unë pas 2 orësh, mamaja ime i lutej të shpëtonin vajzën", tha vëllai i 56-vjeçares. Krahas denoncimit publik, Doko thotë se do bëj denoncim edhe në policinë e Durrësit me qëllim që kjo e fundit te nisi hetimet për rastin ne fjale. Sipas tij ngjarja ka ndodhur tre ditë më parë në urgjencën e spitalit të Durrësit. "Dua të zbardhet ngjarja. Kërkoj të ndërhyhet. Ajo merrte ilaçe kishte 12 vite. Në polici nuk e kam denoncuar ende. Nesër do shkoj në polici për të bërë denoncimin e plotë", vijoi Albert Doko. Nga ana tjetër, jashtë kamerave, mjekët deklarojnë se rasti është trajtuar me përkushtim maksimal, por për fatin e keq pacientja ka ndërruar jete. Mjekësia ligjore po punon për të mësuar shkakun e vërtetë të vdekjes së 56-vjeçares, e cila sipas të afërmve është paraqitur e helmuar nga medikamentet që kishte gëlltitur. Kujtojmë se 56-vjeçarja Ervehe Dedej u gjet pa ndjenja katër ditë më parë në një kanal në zonën e Porto Romanas. Kalimtarë të rastit njoftuan policinë, dhe ajo u transportua menjëherë në urgjencën e spitalit të Durrësit.



Viktima Ervehe Dedej

### "Ndihma nga stafi mjekësor iu dha në kohë"

## Spitali i Durrësit: 56-vjeçarja humbi jetën pasi kishte marrë mbidozë medikamentesh

Pas vdekjes së 56-vjeçares Ervehe Dedej dhe akuzave të vëllait të saj se mjekët nuk e kishin prekur me dorë për 3 orë me radhë, ka reaguar Spitali i Durrësit. Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës i shpreh ngushëllimet familjareve për vdekjen shtetases E. D. dhe sqaron se 56-vjeçarja ka mbërritur në gjendje shumë të rëndë në spital. "Duke shprehur ngushëllimet familjareve për vdekjen shtetases E. D, Drejtoria e Spitalit Rajonal Durrës sqaron se 56-vjeçarja ka ardhur në gjendje shumë të rëndë në spital dhe shumë shpejt ka kaluar ne gjendje kome, më datë 27.08. 2018, në orën 12.22, ku menjëherë ka marrë mjekimin nga stafi mjekësor dhe infermieror i urgjencës së spitalit.




Pas referimit të familjarëve se gruaja vuante nga probleme të shëndetit mendor, mjekët kanë konstatuar se gruaja kishte marrë mbidozë medikamentesh dhe pavarësisht ndihmës së menjëhershme së ekipit mjekësor, 56-vjeçarja ka ndërruar jetë në spital. Në spitalin e Durrësit është bërë autopsia dhe jemi në pritje të ekspertizës mjeko-ligjore për të konfirmuar shkakun e vdekjes së 56-vjeçares",-thuhet në reagimin e spitalit të Durrësit.


Aftësi për Punë / Skills for Jobs

KËRKESË PËR KUOTIM

Swisscontact është një fondacion i pavarur zviceran që promovon zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor. Objektivi i Swisscontact është krijimi i mundësive për të larguar nga varfëria njerëzit e vendeve në zhvillim përmes një zhvillimi ekonomik me bazë të gjerë. Përmes projekteve të ndryshme, Swisscontact lehtëson aksesin në programe të zhvillimit të aftësive, nxit sipërmarrjen konkurruese, krijon akses për shërbimet lokale financiare dhe promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve. Projekti Aftësi pë Punë (Skills for Jobs) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, i zbatuar nga Swisscontact. Projekti është pjesë e Fushës së Zhvillimit Ekonomik të Strategjisë Zvicerane të Bashkëpunimit për Shqipërinë (2014-2017), me fokus të veçantë tek promovimi i mundësive për punësim dhe zhvillimin e aftësive.
Swisscontact, në kuadrin e projektit Skills for Jobs, mandatuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC, për mirëfunksionimin e Qendrave të Karrierës, zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Shkollës, aplikimit të mësimit të kombinuar dhe përmirësimit të infrastrukturës IT në shkollat partnere, kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerjen dhe instalimin e mobiljeve për shkollën "Pavarsia", "Tregtare" në Vlorë, "Kolin Gjoka" Lezhë, "Hamdi Bushati" Shkodër, dhe "Gjergj Canco" Tiranë".

Për më shumë informacion në lidhje me thirrjen, ju lutem drejtohuni në faqen zyrtare të Swisscontact Albania, në linkun si më poshtë:

http://www.swisscontact.org/en/country/albania/our-office/jobs.html




### Godasin me grushte punonjësin e ujësjellësit, arrestohen dy vëllezër në Elbasan

**ELBASAN-** Policia e Elbasanit ka arrestuar ditën në djeshme dy vëllezër, pasi kanë dhunuar punonjësin e ujësjellësit, i cili kishte shkuar në banesën e tyre. Sipas uniformave blu, vëllezërit Andon Bërdufi, 55 vjeç, dhe Uran Bërdufi, 29 vjeç, pasi kanë debatuar me punonjësin e ujësjellësit, 35-vjeçarin F.B., e kanë goditur atë me grushte e sende të forta, duke i shkaktuar dëmtime fizike.

Dy vëllezërit Bërdufi akuzohen se kanë dhunuar punonjësin e ujësjellësit për shkak të detyrës, gjithashtu, ka nisur procedimi penal në gjendje të lirë për këtë të fundit, pasi edhe ai i ka goditur ata me grushte. "Materialet lidhur me ngjarjen i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan, për veprën penale "Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik", parashikuar nga neni 235/2 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve A. Bërdufi dhe U. Bërdufi, si dhe për veprën penale "Plagosja e lehtë me dashje", në ngarkim të shtetasit F.B", thuhet në njoftimin e policisë.

## SHKURT



### Vodhën një automjet, kapen dy vëllezërit, pronarë të një servisi në Berat

Policia e Lushnjës ka vënë në pranga ditën e djeshme 26-vjeçarin Ermir Azizi, banues në Poshnje, Berat dhe ka proceduar në gjendje të lirë vëllain e tij Irfan Azizi, 28 vjeç, pasi akuzohen për vjedhjen e automjetin tip "Benz" në pronësi të shtetasit me inicialet E.N. Nga hetimet e kryera, dyshohet se dy vëllezërit, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, në datën 17.08.2018, në fshatin Kolonjë, Lushnje, kanë vjedhur automjetin tip "Benz" në pronësi të shtetasit me inicialet E.N. Nga kontrolli ushtruar në pikën e varrezave të automjeteve të quajtur "Azizi" në fshatin Poshnje, Berat, në pronësi të shtetasve Irfan dhe Ermir Azizi, është gjetur dhe sekuestruar automjeti tip "Benz", në pronësi të shtetasit E.N, të cilin e kishin çmontuar në disa pjesë me qëllim shitjen e tij për pjesë këmbimi.

### Makina del nga rruga në aksin Bulqizë-Qafa e Buallit, plagosen katër maqedonas

**BULQIZE**- Një aksident me 4 persona të plagosur ka ndodhur në segmentin e Rrugës së Arbrit në vendin e quajtur Vajkal. Një makinë "Citroen" me targa maqedonase, e cila udhëtonte në drejtim të Tiranës ka dalë nga rruga ku për pasojë janë plagosur rëndë 4 personat që ndodheshin brenda saj. Sipas policisë së qarkullimit, e cila ka shkuar menjëherë në vendngjarje, shkak i aksidentit mendohet të ketë qenë shpejtësia e madhe e drejtuesit të automjetit. Aksidenti ka ndodhur pikërisht në vendin ku është dëmtuar edhe Rruga e Arbrit si pasojë e lëvizjes së tokës. Të aksidentuarit ndodhen në spitalin e Bulqizës, ndërsa dy prej tyre u nisën për në Spitalin e Tiranës.

## Dorina Kuka: Brenda 1 dite dhamë rreth 50% të librave

# Nis shpërndarja e teksteve shkollore në 9-vjeçaren "Ali Demi" në kryeqytet



Ditën e djeshme ka nisur shpërndarja e teksteve mësimore të arsimit parauniversitar për vitin e ri shkollor 2018-2019. "Gazeta Shqiptare" ishte e pranishme në shkollën 9-vjeçare "Ali Demi" ku ndoqi nga afër procesin e marrjes së teksteve falas për klasat I-IV. Drejtoresha e kësaj shkolle, Dorina Kuka tregon se procesi po vijon normalisht e më tej thekson se vetëm ditën e parë janë shpërndarë rreth 50% të teksteve. "Jemi gati për fillimin e Vitit të Ri shkollor, një vit i cili besojmë se do të jetë plot përkushtim, suksese dhe dashuri. Deri më tani shkolla 9-vjeçare Ali Demi nuk ka mungesë të teksteve. Tekstet kanë ardhur dhe me përkushtimin e kolegëve procesi i shpërndarjes ka vijuar sot (dje)",-thotë Kuka për 'GSH'. Ndërkohë shpërndarja e teksteve në këtë shkollë është bërë brenda një kohe shumë të shkurtër. "Sjellja në kohë e të gjithë titujve të librave, masave të marra nga drejtoria e shkollës, infrastruktura e krijuar, paketimi në kohë rekord i setit të librave për çdo nxënës bëri të mundur shpërndarjen para datës së caktuar në Udhëzimin e MASR. Sot (dje) u shpërndanë rreth 50% e këtyre librave. Nxënësit dhe prindërit e tyre shprehën falënderimet për vendimin e qeverisë shqiptare për dhënien për herë të parë të librave falas",-shprehet më tej drejtoresha e shkollës 9-vjeçare "Ali Demi". Ndërkohë për sa i përket rritjes së çmimit të teksteve për klasat V-IX, deri më tani stafi i kësaj shkolle thotë se nuk ka marrë asnjë ankesë nga prindërit. Zyrtarisht, shpërndarja e teksteve fillon në 3 shtator ndërsa shkollat e parauniversitarit do të hapin dyert për nxënësit në 17 shtator të këtij viti.

Voltiza Duro/

## Tarifa e depozituar e pakthyeshme dhe e vlefshme vetëm për sezonin aktual të testimit

# Provimi i shtetit për mësuesit në shtator, dokumentacioni që nevojitet

## *QSHA: Kujdes, ja kur mund të penalizoheni*

Voltiza Duro

Prej javës së tretë të shtatorit të këtij viti e në vazhdim, mësuesit do t'i nënshtrohen provimeve të shtetit. Qendra e Shërbimeve Arsimore bën me dije se testimi do të kryhet brenda ambienteve të këtij institucioni dhe i bën thirrje kandidatëve që të paraqesin dokumentacionin e kërkuar. "Ditën e provimit kandidati duhet të jetë i pajisur me: Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë) për pjesëmarrje në provimin e shtetit (dokumenti origjinal); Kopje të Kartë ID ose Pasaportë; Faturën e pagesës së tarifës së provimit të shtetit për llogari të QSHA, nga një bankë të nivelit të dytë/ postë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA) sipas herës së pjesëmarrjes;",-theksohet në njoftimin e QSHA-së. Ndërkohë mësuesit duhet të dorëzojnë edhe një kopje të diplomave të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve të përfunduara prej tyre, si dhe njohjen e tyre nga MAS, në rast përfundimi të programeve të studimit jashtë shtetit. Nëse kandidatët nuk paraqesin ditën e provimit dokumentacionin e sipërpërmendur, atëherë do të humbin mundësinë për të marrë pjesë në provimin e shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit. QSHA më tej bën me dije se kandidatët që regjistrohen për provimin e shtetit, duhet të jenë të pajisur me diplomat e ciklit të parë dhe të dytë të studimit, të lëshuar nga IAL-të përkatëse. "Neni 7 i ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009 thekson sa më poshtë: Neni 7 Formimi dhe kualifikimi profesional për ushtrimin e profesionit të rregulluar personi, që kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar, duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të studimit dhe/ose kualifikime profesionale në atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare, të lëshuara brenda ose jashtë vendit dhe të njohura në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi",-thuhet në njoftim. Kandidatët duhet të zbatojnë rregulloren me përpikmëri në mënyrë që të mos penalizohen. Përkatësisht ata nuk mund të marrin me vete dhe të përdorin celularët apo mjetet e tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter s'kualifikimi. "Tarifa e depozituar për llogari të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, është e pakthyeshme dhe e vlefshme vetëm për sezonin aktual të provimit të shtetit. Për të gjithë kandidatët, lutemi të verifikoni emrin, atësinë, mbiemrin, si dhe datën dhe orën e provimit në faqen zyrtare të QSHA në adresën ëëë.qsha.gov.al, rubrika lista e kandidatëve.",-thekson Qendra e Shërbimeve Arsimore.




REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **“Blerje programesh Software për nevojat e Bankës se Shqipërisë”**

‘Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3.581.600 Lekë”**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “**Blerje programesh Software për nevojat e Bankës se Shqipërisë”**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 02 Tetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.


## Zbardhen datat e provimeve të Maturës Shtetërore 2019

Ministria e Arsimit ka zbardhur datat e provimeve e pushimeve të vitit mësimor 2018-2019, për të gjithë nxënësit e arsimit parauniversitar. Në udhëzimin e përbashkët bëhet me dije se mësimi për arsimin bazë do të fillojë në 17 shtator 2018 e do të mbarojë në 12 qershor të 2019-ës. Ndërkohë pushimet e dimrit do të fillojnë në 22 dhjetor dhe do të përfundojnë në 6 janar 2019. "Provimet kombëtare të arsimit bazë zhvillohen në periudhën 13-30 qershor 2019. Rregullorja e zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë 2019 dhe udhëzimet përkatëse do të miratohen nga ministri",-theksohet në udhëzim. Në këtë të fundit bëhet me dije gjithashtu se mësimet për arsimin e mesëm të lartë do të fillojnë në 17 shtator dhe do të përfundojnë në 19 qershor 2019, ndërsa për maturat viti shkollor do të përfundojë në 4 qershor. Pushimet e dimrit do të merren në po të njëjtën periudhë si arsimi bazë. Ndërkohë provimet e Maturës Shtetërore për vitin 2018-2019 do të zhvillohen në periudhën kohore 6-30 qershor 2019. "Në arsimin profesional mësimet fillojnë në 17 shtator 2018 dhe përfundojnë në 19 qershor 2019 për nxënësit e klasave të 10-ta (për të gjitha strukturat), për nxënësit e klasave të 12-ta (për strukturën 2+2) dhe për nxënësit e klasave të 11-ta dhe të 12-ta (për strukturën bllok 4 vjeçare). Po në këtë arsim profesional, nxënësit e klasave të 11-ta dhe 12-ta (struktura 2+1+1) dhe nxënësit e klasave të 11-ta (struktura 2+2) mësimi do të përfundojë në 7 qershor të 2019-ës. Ndërkohë në 28 maj të vitit 2019 do të përfundojë mësimi për të gjithë maturantët e arsimit profesional",-thuhet në udhëzim.

## SHKURT

### Përfundon rehabilitimi në bllokun prej 47 ha në njësinë Nr. 8 në kryeqytet

Dje ka përfunduar rehabilitimi i infrastrukturës rrugore në bllokun e banimit që kufizohet nga Rr. "Qemal Stafa", Rr. e "Dibrës" dhe Rr. "Bardhyl". Kryebashkiaku, Erion Veliaj, vlerësoi transformimin pozitiv që ka pësuar e gjithë lagja si dhe solli në vëmendje edhe ndërhyrjet e bëra në infrastrukturën arsimore, çka ka sjellë dhe një shfryrje të ngarkesës në klasa, si dhe rritje të cilësisë së mësimdhënies. "Ne i jemi përgjigjur kësaj njësie me dyfishimin e investimeve në këtë njësi. Kemi një paketë me 50 rrugë, 47 ha, pra një bllok të tërë; "4 Dëshmorët", "Qemal Stafa", Rr. e 'Dibrës'", theksoi kryebashkiaku. Ndërkohë deputeti i PS, Ervin Bushati falënderoi bashkinë për investimet në këtë zonë, ndërsa tha se në një vit janë kryer investime më shumë se në 25 vite së bashku.

### AKU bllokon 2 restorante në Burrel, kushte skandaloze

Këtë vit yjet britanikë të muzikës pop, Harry Styles dhe Dua Lipa janë kurorëzuar si dy të famshmit me të pasmet më të bukura në radhët e personazheve të njohura në mbarë botën. Dua triumfoi në sondazhin online brazilian të organizuar nga "Miss Bumbum", duke mbledhur më shumë vota se Kim Kardashian, Nicki Minaj dhe Pippa Middleton. Këngëtarja 23-vjeçare me origjinë shqiptare, mori më shumë vota se ylli brazilian, Anitta, e cila u rendit e dyta dhe Shakira e treta. Ndërkohë, ish-anëtari i One Direction, Harry Styles kryeson listën e meshkujve për të pasmet më të bukura, ku përfshihen Hugh Jackman, Justin Bieber dhe Ronaldo. Ai lë pas Cristiano Ronaldon në vendin e dytë dhe David Beckham në vendin e tretë.





# Më në fund e pamë! ZAIMINA tregon fytyrën e vogëlushes Khloe

Pas shumë postimesh me fytyrë të mbuluar, mesa duket këngëtarja Zaimina Vasjari ka vendosur që në përmujorin e saj të shfaqë edhe fytyrën e vogëlushes. Ajo ka mbushur 7 muaj para disa ditësh dhe ka qenë pikërisht dita kur mami Zai vendosi t'ia bënte publike edhe pamjen e saj të fytyrës. Çdo muaj që kalon Zai e shoqëron me nga një postim mjaft të ëmbël të vajzës së saj të vogël. 'Kartolinë' ka shkruar ajo në foton ku tregon se sa është rritur biondja e saj e vogël. Nga tiparet e fytyrës prej engjëlli duket se vogëlushja 'i ka prerë kokën' të atit. Në postimet e saj më të fundit Zaimina ka treguar se është duke jetuar muajt më të bukur të jetës së saj.







# Para tri ditësh erdhi në jetë Joni, ADELINA TAHIRI publikon foto nga festa e madhe e mirëseardhjes

Më në fund përfundoi pritja e ëmbël për Adelina Tahirin. Lajmin e bukur të ardhjes në jetë të vogëlushit ajo nuk ngurroi ta ndante edhe në 'Instagram' me foton e saj të parë me djalin. Këngëtarja e njohur zbuloi se djali është pagëzuar me emrin Jon dhe emocionet që po përjeton nuk nguroi t'i shprehë me anë të fotos së veçantë. Ndërkaq më vonë nuk kishin se si të mungonin edhe festimet për ardhjen në jetë të Jonit. Ka qenë pikërisht mami Adelina' e cila ka publikuar disa momente nga festa. Mes miqsh dhe familjarësh, me daulle dhe valle, festimet për të voglin ka ngjyrime tipike shqiptare. Kujtojmë se Adelina është e martuar me një biznesmen maqedonas dhe sipas komenteve në fotot në fjalë, festimet po zhvillohen në Shkup.





# Së shpejti, dasmë? ÇILJETA zbulon planet e martesës buzë detit

Prej kohësh këngëtarja Çiljeta Xhilaga është e dashuruar me partnerin e saj, portierin e Kombëtares shqiptare, Alban Hoxha. Edhe pse në fillim të lidhjes, u përpoqën ta mbanin të fshehtë marrëdhënien e tyre, tashmë ata publikojnë foto së bashku në rrjetet sociale. Në një rrëfim për një portal rozë këngëtarja flet për dasmën e saj ideale, çka ngre dyshimet nëse çifti do t'i drejtohet së shpejti altarit. "Ëndërroj çdo ditë për një dasmë buzë detit, diku larg ku të jem vetëm unë, ai dhe njerëzit tanë të dashur." – tregon ajo. Ndër të tjera, këngëtarja e hitit "Hajmali" zbulon se ajo është romantikja në lidhjen e tyre. "Jam shumë romantike, pëlqej shumë të ndez qirinj në të gjithë shtëpinë, të shtroj tryeza për dy, por jam edhe pak posesive në marrëdhënie", – thotë Çiljeta.





# Ç'po ndodh me TUNËN? Tall publikisht regjisorin e klipit të saj!

Pas dy vitesh mungesë, këngëtarja Tuna Sejdi iu rikthye muzikës me këngën e saj me titull "Chonga". Kënga e shkruar nga Seven dhe Elinel, regjistron rreth 2 milionë klikime në "Youtube", pas publikimit në muajin gusht. Duket se "Chonga" nuk do të jetë kënga e vetme e këngëtares, pasi ajo ka nisur xhirimet për realizimin e klipit të një tjetër kënge. Është vetë këngëtarja që shfaq prapaskenat nga xhirimet, ku rrëfen edhe problemet që ka hasur me regjisorin e klipit. "Kur Spielbergat shqiptar t'i dështojnë skenat e ti je e lumtur që të paktën i ke dokumentuar me foto", – shkruan këngëtarja, duke treguar se dikush nga produksioni nuk e ka bërë punën siç duhet. Tuna shfaqet në foto tepër tërheqëse, e veshur me një mantel të bardhë dhe kapele të së njëjtës ngjyrë. Këngëtarja, gjithashtu, ka zgjedhur të mbajë rreth qafës disa rruaza të bardha si dhe vathë të të njëjtit stil.









# Është fejuar? ELVANA GJATA shfaqet me unazë në gisht

Thuhet se prej kohësh këngëtarja e njohur, Elvana Gjata ka ndryshuar status dhe është fejuar, por unazën e saj floriri e dalluam vetëm mbrëmjen e së enjtes në postimet e publikuara në 'Instagram'. Këngëtarja, e cila po provon aftësitë e saj në aktrim duke xhiruar një film me Ermal Mamaqin, publikoi 5 foto ku shfaqet vetëm profili i saj dhe detaji që tërheq më shumë vëmendjen është unaza në gishtin e fejesës së dorës së djathë. Unaza nuk ka shpëtuar pa u vënë re edhe nga ndjekësit e saj në rrjetin social, të cilët pyesin të habitur nëse Elvana është fejuar duke bërë urimet përkatëse.

# Të dashuruar si ditën e parë, ROBERT BERISHA tregon sekretin e martesës së lumtur me NORA ISTREFIN

Ata janë padyshim një nga çiftet më të dashur të mediave rozë. Robert Berisha dhe Nora Istrefi janë të martuar prej 4 vitesh dhe sot janë prindër të një vajze 3-vjeçare. Dy këngëtarët e njohur kanë aq shumë vite bashkë saqë na duket sikur i kemi parë gjithmonë ashtu. Mirëpo të gjithë jemi kuriozë të dimë se cili është sekreti i një martese kaq jetëgjatë dhe mbi të gjitha të lumtur. Në një intervistë për median Robert Berisha ka rrëfyer se ku qëndron sekreti i martesës së lumtur mes tij dhe Norës. "Nuk ka sekrete për një martesë të lumtur, vetëm dashuri dhe respekt. Shumicën e kohës jemi bashkë, përveç një të shtune në javë. Nga e diela deri të premten jemi bashkë, kurse çiftet e tjerë, të cilët punojnë tetë orë nga e hëna në të premte, shihen më pak se ne",-thotë këngëtari duke na lënë të kuptojmë se fakti që ata kalojnë shumë kohë bashkë është sekreti i martesës së tyre të lumtur. Roberti në këtë intervistë ka zbuluar, gjithashtu, se mes tij dhe Norës nuk ka konkurrencë edhe pse punojnë në të njëjtën industri. "Nuk e shoh Norën si konkurrencë, por vetëm si personin që dua fort",-ka thënë Roberti.





Opinioni i Ditës

**1 shtator 1928 - 1 shtator 2018, 90-vjetori i Mbretërisë Shqiptare**

# Shpallja e Monarkisë domosdoshmëri kombëtare dhe e ligjshme

Nga Ekrem Spahiu

*(vijon nga faqja 1)*

...ndryshimet e Statutit, ku dy më kryesoret ishin: "Shqipëria është Mbretëri demokratike, parlamentare dhe e trashëgueshme" dhe "Mbret i Shqiptarëve është Nalt Madhëria e Tij - Zog I".

Kalimi i Shqipërisë në sistemin monarkik të formës së regjimit, ishte, në fakt, kalim në një sistem më afër tradicionales dhe më të pranueshëm për shqiptarët, se sa sistemi republikan. Mbretërinë e instaloi i njëjti personalitet, i cili tre-katër vite më parë kishte instaluar Republikën dhe ishte shpallur President i kësaj Republike. Ky akt është pritur dhe vlerësuar me kundërthënie nga më të ndryshmet. Vlerësimi më radikal ka qenë se monarkia e instaluar nga Ahmet Zogu nuk ka qenë e ligjshme dhe ishte thjesht shprehje e ambicieve personale të Ahmet Zogut.

Një vlerësim tjetër është se instalimi i mbretërisë nuk ka qenë i ligjshëm, por një akt politik i domosdoshëm për stabilitetin dhe sigurinë kombëtare të Shqipërisë. Një vlerësim i tretë është se instalimi i mbretërisë ka qenë domosdoshmëri kombëtare dhe është bërë në mënyrë krejtësisht të ligjshme.

Nga pikëpamja juridike, të tria vlerësimet meritojnë vëmendje, për më tepër që mbretëria, si sistem politik e ka në rrënjë mbretërinë e ligjit si sistem juridik. Atëherë, le të ndalemi tek disa aspekte të instalimit të mbretërisë në Shqipëri.

Sikurse e thamë, i njëjti personalitet që drejtoi vendin për rreth katër vjet në cilësinë e Presidentit dhe Kryeministrit, po ai u shpall edhe Mbret i Shqiptarëve. Nëse kjo do të ishte çështje vullneti apo ambiciesh politike, atëherë çfarë apo kush mund ta ndalte Ahmet Zogun që ta instalonte Mbretërinë qysh më 1924, ku u rikthye në pushtet? Autoritetin e kishte. Vlerat drejtuese i kishte shprehur edhe më parë, madje në një post mjaft delikat si ai i Ministrit të Brendshëm. Kundërshtarët politikë të udhëhequr nga Fan Noli, që erdhën në pushtet në rrugë jolegjitime nuk gëzuan asnjë njohje ndërkombëtare dhe u larguan pas gjashtë muajve nga pushteti (24 dhjetor 1924). Shqipëria nuk kishte një traditë politike dhe në këto kushte mund të bëje si të doje. Atëherë, përse nuk e bëri Ahmet Zogu qysh në fillim këtë akt të shpalljes së Mbretërisë? Për hipokrizi?

E vërteta është krejt ndryshe. Ahmet Zogu u tregua shumë i kujdesshëm në hapat e tij për ta ndryshuar formën e regjimit në Shqipëri nga Republikë në Monarki, duke punuar në disa drejtime dhe për të qenë në harmoni me procesin politik, opinionin publik shqiptar, bindjen dhe mbështetjen e marrë nga faktori ndërkombëtar e në veçanti nga Fuqitë e Mëdha, dhe mbi të gjitha me nismat dhe respektimin e procedurave kushtetuese e ligjore.



Ahmet Zogu nuk mund të bënte një hap politik që do të ishte në kundërshtim me të drejtat e trashëgimisë. Sikurse është e njohur, në Konferencën e Ambasadorëve 29 korrik 1913, midis të tjerash, ishte vendosur qysh në pikën 1 të Deklaratës se: "Shqipëria konstituohet si një principatë autonome, sovrane dhe e trashëgueshme sipas rrjedhës së paraardhësve të një gjaku, nën garancitë e gjashtë Fuqive të Mëdha. Princi do të caktohet nga gjashtë Fuqitë e Mëdha". Po ashtu, dimë se menjëherë pas Konferencës së Ambasadorëve, u caktua edhe trashëgimtari që do të ushtronte këtë funksion, princi me origjinë gjermane Vilhelm Vid, i cili nuk mundi të qëndrojë më shumë se sa rreth 6 muaj (7 mars-3 shtator 1914) për të ushtruar pushtetin princëror të tij.

Princi Vilhelm Vid, edhe pse i larguar, asnjëherë nuk pati shpallur abdikimin për të liruar rrugën, qoftë për mbret apo princ pasardhës, qoftë edhe për të hapur rrugën ndryshimit të regjimit. Në këto kushte, më 1924, Ahmet Zogu nuk mund të shpallte vijimin e rrjedhës mbretërore/princërore, sepse kjo i takonte vetëm Princit Vilhelm Vid. Atëherë, Ahmet Zogu zgjodhi rrugën e dytë: shpalljen e Shqipërisë Republikë dhe të vetes së tij President dhe Kryeministër.

Por e pashpjeguar mirë në historiografinë e Shqipërisë deri tani, është se përse Ahmet Zogu nuk u shpreh ekskluzivisht dhe paralelisht se "Nuk njeh mbretërinë", kur ai e shpalli Shqipërinë "Republikë" dhe veten "President dhe Kryeministër"? Mendoj se pikërisht këtu qëndron çelësi i shpjegimit dhe jo sikurse e shpjegojnë një kategori historianësh, të cilët shprehen se me shpalljen e Shqipërisë Republikë dhe të Ahmet Zogut si President të saj, u suprimua plotësisht forma monarkike e qeverisjes në Shqipëri.

Ahmet Zogu, në vitin 1925, kur erdhi në krye të Republikës si President, shpalli një lloj regjimi që të ishte i pranueshëm dhe në dobi të popullit e shtetit shqiptar, një regjim të tillë që do të vendoste në rrugë institucionale, funksionimin e gjithë shoqërisë dhe të politikës shqiptare, të cilat prej 13 vjetësh nga shpallja e pavarësisë, kishin qenë në kaos të plotë. Ndërkohë, me këtë akt, Ahmet Zogu nuk shpalli mosnjohjen e mbretërisë. Përkundrazi, ai la hapur mundësinë e vijimësisë mbretërore.

Sapo Zogu e forcoi shtetin në masën e mjaftueshme për të qenë i aftë të marrë dhe të administrojë pushtetet e veta, atëherë ai shkoi përsëri në origjinën politike të njohur apo të deklaruar edhe nga Fuqitë e Mëdha: mbretërinë e trashëgueshme. Për të kaluar këtë "prag politik", mbetej vetëm një pengesë: Princi Vilhelm Vid ishte gjallë dhe ai ende nuk qe shprehur nëse vijonte të pretendonte fronin mbretëror apo abdikonte prej këtij froni, duke ia lënë dikujt tjetër mundësinë ta trashëgojë. Në këtë kuadër, shumë historiografë e kanë deformuar apo nuk e kanë lexuar si duhet referimin për deklaratën e Princ Vidit të datës 24 gusht 1928, të cilën po e citojmë me korrektesë siç është sjellë nga autori i paanshëm Ouen Pearson, në librin e tij "Shqipëria dhe Mbreti Zog" (faqe 292-293), "Ish Mbreti Vilhelm, Princi Vidi, i cili kurrë nuk kishte abdikuar, lëshoi një deklaratë me të cilën shpallte se ai i pretendonte për veten dhe për trashëgimtarët e tij të gjitha të drejtat për fronin e Shqipërisë, me gjithë aspiratat e Ahmet Zogut për të qenë mbret. Ai i qëndronte mendimit, besimit, se shumica e shqiptarëve e mbështesnin akoma atë, por ai ndjente se kthimi i tij i menjëhershëm nuk mund të diskutohej, përderisa nuk ishte e mundur të zhvillohej një referendum i lirë dhe i pandikuar në atë kohë. Ai deklaroi se ai ishte i lirë nga ambiciet e tij personale dhe se kurrë nuk kishte ndërmend të provokonte mospajtime midis shqiptarëve, pasi bashkimi, përparimi dhe prosperiteti i të cilëve kishte qenë dhe ishte akoma synimi i vetëm i tij. Kështu ai do të shmangte vështirësitë politike të brendshme dhe të jashtme, duke pritur momentin e përshtatshëm për t'u kthyer në Shqipëri, e cila do të parakuptonte domosdoshmërisht një dëshirë unanime të popullit".

Deklarata është bërë, sikurse e thamë më lart, në datën 24 gusht 1928. Ndërkohë, dihet që Asambleja Kushtetuese e shpalli Shqipërinë - Mbretëri në datën 1 shtator 1928. Atëherë, cili është leximi që duhet konsideruar si themeli i procesit të ligjshëm?

Shpallja e Shqipërisë - Mbretëri u bë pasi u deklarua Princi i ligjshëm i saj, Vilhelm Vid. Por tashmë ish Princi, në deklaratën e vet, u shpreh se ai kurrë nuk kishte abdikuar, gjë që do të thotë se, në një farë mënyre, ai e pranonte se ekzistonte edhe mundësia e abdikimit. Ish Princi, pranon gjithashtu se ky abdikim do të mund të ishte i arsyetuar pas mbështetjes ose jo të popullit shqiptar, të cilën ai mendonte se e kishte. Ndërkohë, ai ndjente se mbështetja duhej "lexuar" përmes një referendumi, ku populli të shprehte vullnetin e tij. Këto labirinte arsyetimesh, nxjerrin në pah se, për shumë arsye, Princ Vidi e kishte humbur besimin dhe ndoshta të drejtën për të vijuar mbretërimin. Të mos harrojmë se ai ishte larguar prej 14 vjetësh nga Shqipëria, duke mos ushtruar asnjë atribut.

Tani vijmë tek momenti vendimtar që përcakton llojin dhe përfaqësuesin e një regjimi legjitim: mbështetja popullore. Cili ishte vullneti i popullit që kërkonte Vidi? A nuk e përfaqësonte Asambleja Kushtetuese vullnetin e popullit? A premtonin ato kohë të trazuara që të organizohej e të zhvillohej një referendum klasik sikurse e kërkonte Princi që kishte "humbur"?

Atëherë, në thelb, e gjithë deklarata e ish Princit mund të interpretohet pak a shumë kështu: "Mbretëria duhet të vazhdojë. Unë (ish Princi) jam njeri prej atyre që mund ta pretendojnë këtë fron, por për këtë duhet pyetur populli". Sikurse është e njohur, populli, me fuqinë e Asamblesë Kushtetuese u shpreh, se Mbretëria duhet të vazhdojë. Gjithashtu, po në emër të vullnetit të popullit shqiptar, Asambleja përcaktoi edhe Mbretin - një shqiptar të madh, i cili e ka treguar veten se di të realizojë atë dëshirë e synim fisnik të vetëm që kishte edhe ish-Mbreti Vilhelm Vid - bashkimin, përparimin dhe prosperitetin e shqiptarëve.

Pavarësisht nga deklarata e Princ Vidit më 24 gusht 1928, Zogu në këtë çështje tregoi kujdes të veçantë, se i trembej gjetjes së ndonjë hapësire tjetër ligjore nga Fuqitë e Mëdha për rikthimin e Vidit në fronin e Shqipërisë. Si rrjedhim, lëvizjet e tij për të fituar kurorën mbretërore shqiptare gjatë periudhës së parë të aktivitetit politik në krye të shtetit shqiptar ishin kryesisht të ngadalta dhe shumë të matura. Zogu dhe ndihmësit e tij mendonin se ishte e domosdoshme fillimisht të bënin përpjekjet maksimale për të bindur Fuqitë e Mëdha si dhe për të siguruar mbështetjen e tyre në aritjen e këtij synimi madhor për të ardhmen e Shqipërisë dhe të tij. Pikërisht për këtë çështje historiania Valentina Duka, në librin "Monarkia Shqiptare 1928-1939" shkruan: "Më në fund, diplomacia britanike dhe ajo europiane në

përgjithësi, të bindura edhe nga diplomacia italiane, tejet aktive në këtë mes, si dhe të etura për të parë një Ballkan të qëndrueshëm, u pajtuan për t'i hapur dritën e gjelbër ndryshimit të formës së qeverisjes në Shqipëri".

Edhe pse arriti ta bindë faktorin ndërkombëtar, Zogu e kuptonte se një ndryshim i tillë kushtetues kërkonte domosdoshmërisht përgatitje të shumta edhe në planin e brendshëm. Duke qenë kurdoherë mjaft i kujdesshëm për ruajtjen e formës legale, ai u përpoq që ky ndryshim të bëhej brenda një kuadri kushtetues të rregullt.

Meqenëse, juridikisht, Asamblesë nuk i njihej e drejta që të ndryshonte Kushtetutën, u vendos rishikimi i përgjithshëm i Statutit (Kushtetutës) dhe për këtë, ishte e domosdoshme që deputetët të votonin një ligj organik. Në atë kohë, në vendin tonë ishin dy Dhoma, njëra e Deputetëve dhe tjetra e Senatorëve. Më 7 qershor 1928, u mblodhën dy Dhomat në një mbledhje të përbashkët dhe për të qenë në përputhje me shkronjën dhe frymën e Statutit, vendosën një shtojcë të nenit 141 me këtë përmbajtje: "Rishikimi i përgjithshëm i Statutit i përket vetëm Asambles Konstituente".

Kur vendoset nevoja e rishikimit të përgjithshëm të Statutit, dy Dhomat quhen vetvetiu të shpërndara dhe dekretohen zgjedhje për Asamblenë Konstituente.

Më 17 gusht 1928, u zhvilluan zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese dhe asambleistat e dalë nga populli në këto votime, filluan mbledhjet më 25 gusht. Më 1 shtator 1928, ora 09.12, Asambleja Kushtetuese në mbledhjen e saj të katërt me vota unanime miratoi ndryshimet e Statutit, ku dy më kryesoret ishin: "Shqipëria është Mbretëri demokratike, parlamentare dhe e trashëgueshme" dhe "Mbret i Shqiptarëve është Nalt Madhëria e Tij - Zog I".

Në një mënyrë shumë domethënëse për një vend me disa besime, Zogu bëri betimin mbi Bibël dhe Kuran: "Unë, Zogu, mbret i shqiptarëve, me rastin e marrjes në duart e mia të fuqisë mbretërore, betohem para Zotit të plotfuqishëm se do të ruaj unitetin kombëtar dhe integritetin territorial të shtetit. Unë do t'i përmbahem me besnikëri Kushtetutës dhe do të veproj në bazë të akteve të saj dhe ligjeve në fuqi, duke mbajtur gjithnjë parasysh vullnetin e popullit". Në bazë të statutit të ri të Mbretërisë, Asambleja Kushtetuese u transformua në Parlament dhe e filloi mbledhjen e vet të parë me këtë cilësi të re, më datë 10 dhjetor 1928.

Përgatitja e opinionit publik shqiptar për kalimin nga republikë në monarki dhe zgjedhjen e Ahmet Zogut - Mbret të shqiptarëve, ishte shumë i domosdoshëm përpara se ky veprim të ekzekutohej. Stafi pran Zogut i kushtoi një rëndësi të madhe sensibilizimit të opinionit publik për këtë ngjarje historike kombëtare, ku u bë me të gjitha mjetet e duhura, por kryesisht nëpërmjet organeve të shtypit shqiptar dhe të huaj. U organizuan manifestime dhe mitingje, ku populli kërkonte ndryshimin e formës së regjimit dhe shpalljen e Zogut - Mbret. I pari telegram që mbërrin në Tiranë ishte ai i zgjedhësve të Skraparit, dërguar më 17 gusht, ku kërkohej zgjedhja e Ahmet Zogut si Mbret. Si Skrapari vepruan edhe prefektura dhe nënprefektura të tjera. Ky organizim dhe kjo atmosferë festive kulmuan me një miting të madh më 30 gusht në Tiranë.

Sigurisht që faktori ndërkombëtar ishte i informuar dhe i kishte dhënë Zogut mbështetje të plotë për këtë proces. Njohja zyrtare e Mbretërisë u bë në fillim nga Italia dhe në vijim, nga Hungaria, SHBA, Greqia, Jugosllavia, Uruguaji, Austria, Bullgaria, Franca, Holanda, Belgjika, Zvicra, Spanja, Polonia, Lituania, Letonia, Suedia, Finlanda, San Marino, Ekuadori, Egjipti, etj.

Këto ishin pra kushtet dhe rrethanat, por edhe fazat e kalimit të procesit ku u vendos dhe u legjitimua monarkia në Shqipëri. Çështja e legjitimitetit është një çështje madhore që lidhet drejtpërdrejt me stabilitetin politik dhe sigurinë kombëtare. Kjo formë qeverisje, erdhi edhe si vlerësim i përgjithshëm i situatave reale që kishte dhe po kalonte vendi, por edhe si domosdoshmëri, për të dalë mbi forcat e ndryshme politike dhe mbi krerët lokale, pasi rreziku i grindjeve partiake dhe individuale për të ardhur në pushtet me çdo mënyrë, shihej si një problem i madh kombëtar.

Periudha nga viti 1912 deri në ardhjen në fuqi të Monarkisë, ka qenë periudha më e destabilizuar e vendit dhe, rrjedhimisht, më e prekshmja për sigurinë kombëtare të Shqipërisë. Në këto kushte, për Shqipërinë dhe shqiptarët kudo ku jetonin, nuk kishte zgjidhje tjetër shpëtimi, mbijetese e sigurie kombëtare, përveçse të kalohej në një përqendrim edhe më të madh të energjive, përpjekjeve dhe forcave të të gjithë kombit, gjë që u mishërua në zgjidhjen politike të instalimit të Monarkisë.

Me shpalljen e Shqipërisë Mbretëri, u krijuan kushte të favorshme për t'u ushtruar plotësisht pushteti dhe qeverisja në të gjithë territorin e vendit dhe dhënien fund të intrigave dhe prapaskenave, në dëm të interesave të vendit. Gjithsesi, kjo mund të vlerësohet edhe si një mundësi për të ndikuar personalisht në zgjidhjen e problemeve kombëtare, në kushtet e klanizimit të politikave të brendshme shqiptare.

Formula dhe betimi mbi Kuran dhe mbi Bibël, u konsiderua faktor i rëndësishëm për stabilitetin, sigurinë dhe mbarëvajtjen e punëve shtetërore. Ai materializoi idenë e bashkëpunimit me të gjitha institucionet fetare, duke bërë hapa konkretë për të siguruar faktorë të rëndësishëm mbështetës e gjithëpërfshirës në çështjet e sigurisë kombëtare, ndër të cilët bashkëjetesa e feve të ndryshme, konsiderohej themelore.

Shpallja e Ahmet Zogut, Mbret i Shqiptarëve shënoi fillimin e fazës më të rëndësishme të realizimit të vizionit të tij për konsolidimin e shtetit dhe të gjithë instrumenteve që i japin kuptim qeverisjes moderne të tij.

Si përfundim, duhet thënë se gjendja e Shqipërisë përpara vendosjes së monarkisë, ka arsye të ndahet në dy periudha: në periudhën 1912-1925 dhe në atë të viteve 1925-1928. Të dy periudhat i ndan fakti se, në të parën, Shqipëria, edhe pse bëri "kapërcimin e ylberit", d.m.th., kaloi nga gjendja e pushtimit 500-vjeçar në gjendjen e të jetuarit si komb më vete, nuk arriti, prapëseprapë, të formonte një shtet për të qenë, një shtet serioz që të kishte forcën e vet brenda vendit dhe fjalën e vet jashtë vendit. Sistemi politik qe i mjegullt dhe shumë i paqëndrueshëm.

Në kushtet e ndarjeve krahinore e fisnore, si dhe për shkak të ndikimeve të interesave të ndryshme të brendshme e të jashtme, në një periudhë prej vetëm 7 vjetësh pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, do të vinin e do të largoheshin plot 14 qeveri me kryeministrat: Myfid Bej Libohova, Fejzi Bej Alizoti, Turhan Pashë Përmeti, Esat Pashë Toptani, Sulejman Delvina, Iljas Bej Vrioni, Pandeli Evangjeli, Qazim Koculi, Hasan Prishtina, Omer Pashë Vrioni, Xhaferr Ypi, Ahmet Zogu, Shefqet Vërlaci dhe Fan Noli. Madje në dhjetor të vitit 1921 për shkak të ambicieve personale dhe konflikteve të vazhdueshme ndërmjet grupimeve politike, në vetëm 18 ditë, si pasojë e kësaj situate u ndërruan tre kryeministra, qëndrimi i të cilëve në qeverisje u mat me ditë: Qazim Koculi për një ditë, Hasan Prishtina për 5 ditë dhe Idhomeno Kosturi për 12 ditë.

Sikurse duket qartazi, Shqipëria, në këto vite, ka qenë në vakum pushteti, me mungesë stabiliteti dhe rrjedhimisht, e prekur edhe në sigurinë e vet kombëtare. Kjo paqëndrueshmëri politike në vend u pasqyrua edhe në takimet kryesore zyrtare evropiane ku vendoseshin fatet e vendit tonë. Elementi zyrtar shqiptar, në më të shumtën e rasteve, nuk ka qenë i pranishëm. Por edhe në rastet kur ka qenë i pranishëm, ai ka qenë i përçarë, sikurse ishte Konferenca e Paqes së Parisit në 1919 – shembulli më kuptimplotë.

Në këto kushte, Shqipëria nuk ishte thjeshtë e përçarë dhe e izoluar, por thuajse e lënë pas dore nga bota dhe, në rastin më ekstrem, e rrezikuar për të humbur edhe sigurinë kombëtare. Vendi ishte zhytur në varfëri. E vetmja zgjidhje ishte emigracioni, i cili, në ato vite, jo vetëm filloi, por edhe u masivizua si kurrë ndonjëherë.

Përkundrazi, në periudhën e dytë (1925-1928), që jo rastësisht lidhet me emrin e Ahmet Zogut, edhe pse brenda një kohe fare të shkurtër, Shqipëria u fut në rrjedhën e individualitetit të shtetit, të forcës dhe të fjalës së tij. Shqipëria filloi të pyetej në arenën ndërkombëtare, madje t'i dëgjohej edhe fjala sikurse ishte rasti për Çamërinë. Shteti, pothuajse u plotësua në infrastrukturën e vet politike. Gjithsesi, ajo që i bashkon të dyja periudhat është varfëria përgjithësisht e skajshme e vendit, infrastruktura e dobët, sistemi arsimor jo i zhvilluar, sistemi ligjor jofunksional dhe përfaqësimi diplomatik në botë jo i plotë.

Duke marrë parasysh sa më sipër, si dhe faktin tepër të rëndësishëm se, pikërisht në ato vite, situata e sigurisë në Ballkan dhe në Evropë po shkonte drejt përkeqësimit, atëherë për Shqipërinë dhe shqiptarët kudo ku jetonin, nuk kishte zgjidhje tjetër shpëtimi, mbijetese e sigurie kombëtare, përveçse të kalohej në një përqendrim edhe më të madh energjish, përpjekjesh dhe forcash të të gjithë kombit, gjë që u mishërua në zgjidhjen politike të instalimit të Monarkisë.

Një përvojë të tillë të përqendrimit të pushtetit politik në kohë rreziqesh të mëdha për sigurinë kombëtare e kanë përjetuar shumë kombe, pavarësisht se në çfarë forme është bërë ky përqendrim. Kështu pat vepruar dikur Gjermania nën "Monarkun" Bismark. Kështu patën vepruar edhe fqinjët tanë më të afërt, Serbia, Greqia, etj. Shqipëria nuk kish pse bënte përjashtim nga ky rregull. Përndryshe ajo do të vijonte të bëhej objekt lakmish të egra. Kalimi nga regjimi i Republikës në regjimin e Mbretërisë ishte, jo vetëm i domosdoshëm, por edhe i ligjshëm. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse një qeverisje legjitime është guri i themelit të stabilitetit politik dhe sigurisë kombëtare. Këtë legjitimitet, Ahmet Zogu e fitoi me mjete të ligjshme dhe me kontribute të spikatura të udhëheqësit të pranuar dhe të mbështetur në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Se çfarë arritën shqiptarët dhe Shqipëria nën drejtimin e Mbretit Zog I gjatë 11 viteve të Mbretërisë, është temë në vete dhe duhet trajtuar në një shkrim të veçantë.



## HOROSKOPI

**DASHI**

Energjia dhe entuziazmi juaj janë në nivel maksimal sot ndërsa dhe çështjet financiare apo të dashurisë po shkojnë mjaft mirë. Vazhdoni të mbani këtë rrugë.

**DEMI**

Teksa çështjet e karrierës dhe parave po shkojnë mbare për ju, ide të reja mund t'ju lindin që do t'ju zgjerojnë horizontin. Megjithatë do ta keni të vështirë që të zgjidhni.

**BINJAKET**

Jeni energjik dhe plot entuziazëm ndaj do të ndiheni i motivuar për të çuar përpara ëndrrat tuaja që mund të bëhen realitet nëse tregoni vendosmërinë e nevojshme.

**GAFORJA**

Sot mund të përfshiheni nga tensionet me një ortak në biznes. Mos harxhoni shumë kohë duke menduar për këtë. Çështjet financiare dhe ato te dashurisë po shkojnë mirë për ju.

**LUANI**

Sot mund të merrni një mundësi të mirë pune, por që do të jetë jashtë vendit. Kjo do t'ju kërkonte shumë udhëtime. Mund te jeni i dyzuar për këtë ide, por nuk do ta refuzoni.

**VIRGJERESHA**

Përparimi në karriere është duke u afruar për ju. Nëse keni ëndërruar për diçka në fushën profesionale, sot do të jeni i aftë që ta realizoni atë. Nëse dëshironi të hapni një biznes, mos prisni një moment tjetër.

**PESHORJA**

Sot mund të mos jete dita e duhur për të firmosur marrëveshje me partnerët në punë. Mos u përpiqni t'i bëni gjerat me presion. Kini durim që gjerat të shkojnë në vendin e duhur.

**AKREPI**

Sot mund t'ju vije një shans për të shtuar të ardhurat tuaja. Për këtë do t'ju duhet shumë punë dhe investime. Sidoqoftë, do të ndiheni financiarisht më i sigurtë.

**SHIGJETARI**

Do të jeni i kënaqur me rezultatin e punës suaj. Do të merrni komplimente dhe mirënjohje. Gjate orëve të mbrëmjes dilni me miqtë dhe kaloni një kohë të bukur.

**BRICJAPI**

Do të gëzoni shëndet të mirë. Fizikisht ndiheni i fortë dhe plot energji. Edhe gjendja psikologjike paraqitet shumë e mirë, kjo do t'ju bëjë të mendoni me shumë për perfeksionim profesional.

**UJORI**

Sot mund të keni një oferte apo mundësi të mirë për punë. Mjafton që të këmbëngulni se zotëroni aftësitë e duhura dhe dyert do të jenë të hapura për ju.

**PESHQIT**

Sot mund të keni shansin të hapni një biznes tuajin. Mos u habisni nëse gjerat ju ecin mbarë menjëherë dhe pa pengesa. Përgatituni për një të ardhme të ndritur.

Opinioni i Ditës

# Diskutimet për shkëmbim territoresh janë të gabuara

Zëri i Amerikës

*(vijon nga faqja 1)*

... ministrave të Jashtëm të Bashkimit Evropian me ata të vendeve kandidate për anëtarësim, në Vjenë, ministri i Jashtëm gjerman Heiko Maas, tha se diskutimet për shkëmbim territoresh janë të gabuara.

"Ne besojmë se kjo mund të hapë shumë plagë të vjetra dhe së këndejmi jemi shumë skeptikë," u tha ministri Maas gazetarëve. Edhe disa nga ministrat e tjerë të Jashtëm të vendeve të Bashkimit Evropian, ritheksuan qëndrimin kundër ndryshimit të kufijve.

Ministri i Jashtëm i Luksemburgut, Jean Asselborn, shfaqi drojën për "pasojat shumë negative", ndërsa shefi i diplomacisë finlandeze, Timo Soini, tha se kjo do të ishte e rrezikshme.

Shqetësim shfaqi edhe ministrja e Jashtme e Austrisë, Karin Kneissl, vendi i së cilës kryeson Bashkimin Evropian. "Nuk dua të mbajë leksione por ndryshimet e kufijve gjithnjë kanë krijuar probleme të reja", tha ajo.



Edhe Britania e Madhe ka tërhequr vërejtjen se shkëmbimi i territoreve do të ishte destabilizues.

Ministrat e Jashtëm mbështetën ndërkaq bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilat pritet të vazhdojnë më 7 shtator, me ndërmjetësimin e shefes së politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini. Ajo tha të premten në Vjenë se do të mbështesë çdo zgjidhje që nuk çon në krijimin e shteteve njëetnike.

"Çfarëdo që të jetë rezultati i një marrëveshjeje të ndërsjellë, do ta këtë mbështetjen tonë, me kusht që ajo të jetë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, the ligjet e Bashkimit Evropian. Ju e dini historinë e Evropës. Ajo është e mbështetur në tejkalimin dhe parandalimin e çdo ideje për shtete etnikisht të pastra". tha zonja Mogherini, por nuk deshi të shpalosë hollësi mbi çfarë baze janë duke diskutuar presidenti i Kosovës Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, të cilët po ashtu nuk kanë dhënë hollësi se si mund të dukej një marrëveshje përfundimtare dhe çfarë ndryshimesh do të përfshinte.

Presidenti serb e ka shpallur politikë të tij ndarjen ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në vija etnike. Presidenti i Kosovës, thotë se korrigjimi i kufijve do të nënkuptonte bashkimin me Kosovën të luginës së Preshevës, një zonë me shumicë shqiptare në jug të Serbisë.

Të dy presidentët kanë pohuar se arritja e një marrëveshjeje është të pothuajse e pamundur, ndërsa zonja Mogherini tha sot se është shumë e vështirë, por jo e pamundur që të zgjidhet situata më e ndërlikuar dhe me shumë pasoja për rajonin, që po vazhdon edhe 20 vjet pas konfliktit.

Serbia është zotuar se nuk do të njohë pavarësinë e Kosovës, që u shpall në shkurt të vitit 2008 me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara dhe vendeve kryesore të Bashkimit Evropian. Por, ajo është të përshirë në një proces bisedimesh për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, që është edhe kusht për integrimet evropiane të të dyja palëve.

Afrim i zgjedhjeve në Bashkimin Evropian që mbahen në pranverën e vitit të ardhshëm, ka shtuar trysninë mbi të dyja palët për një marrëveshje më të shpejtë dhe zonja Mogherini tha të premten se, qartazi synimi është një marrëveshja para përfundimit të mandatit të saj.

Opinioni i Ditës

# Përgjigje shpifjeve të Margarita Kolës dhe sektit terrorist muxhahedin

Nga Mostafa Mohammady dhe Mahbube Hamza

Në një letër që avokatja e grupit ish-terrorist të muxhahedinëve Margarita Kola i ka çuar mediave shqiptare, znj. Kola ka përsëritur shpifjet dhe gënjeshtrat që sekti i muxhahedinëve hedh kundër meje dhe vajzës sime që ata mbajnë peng. Për këtë arsye ne prindërit e Somayehs kemi shkruar këtë përgjigje për znj. Margarita Kola:

E para, ne i themi znj. Margarita Kola që në letrën e saj që është shkruar në emër të një grupi fantazmë të ashtuquajtur "Komiteti i Juristëve për PMOI-në në Shqipëri (CJPA)" ajo përsërit gënjeshtrat që terroristët muxhahedinë hedhin kundër meje dhe qindra prindërve të fëmijëve që ata mbajnë peng në Shqipëri. Ajo thotë që unë Mostafa Mohammadi kam ardhur në Shqipëri për të mashtruar opinionin publik dhe kryer një fushatë denigruese kundër ish-organizatës terroriste MEK.

E dyta, ajo pretendon se unë jam agjent i qeverisë iraniane që bëj presion psikologjik mbi vajzën time që ajo të dorëzohet, d.m.th. braktisë xhihadin dhe terrorizmin dhe bëhet një njeri normal dhe të ketë një jetë civile larg ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.

E treta, ajo pretendon se Somayeh qëndron me dëshirën e saj në kampin ushtarak të MEK-ut dhe refuzon me dëshirë Kanadanë dhe jetën e lirë.

E katërta, ajo ripërsërit slloganet idiote propagandistike të MEK-ut, i cili pretendon se MEK-u është organizatë demokratike dhe revolucionare, ndërsa regjimi iranian planifikon sulme kundër pleqve dhe plakave të MEK-ut dhe unë jam pjesë e këtyre sulmeve. Në mënyrë anti-ligjore ajo i kërkon qeverisë shqiptare që të më përzërë mua nga Shqipëria në mënyrë që terroristët dhe pengmarrësit e MEK-ut të mos përballen me mua përpara bankës së gjykatës.

Për sa më sipër, ne familja e Somayehs i themi znj. Kola:

1. Të kesh turp për shpifjet që hedh kundër meje, familjes sime dhe bëhesh palë me një bandë ish-terroriste dhe pengmarrëse që mua më ka rrëmbyer vajzën time që prej 21 vitesh. Po të ishe juriste e vërtetë ti duhej të mos luaje me kartën që je ish punonjëse e ambasadës amerikane, dhe të mos shantazhoje njerëzit lart e poshtë me slloganin: "E di ti kush jam unë, po ta dije do të ruaje vendin e punës!". Një juriste e vërtetë respekton ligjin, dhe nuk shkruan shpifje në media, pasi ti si avokate e di shumë mirë çfarë është vepra penale me karakter vazhdues, vullneti i vesuar, liria e personit, privimi nga e drejta e lëvizjes së lirë, prezumimi i pafajësisë, çfarë është ndryshimi midis arrestimit dhe shoqërimit në polici, çfarë do të thotë vendim i formës së prerë apo e drejtë ankimi. Po t'i respektoje këto të drejta nuk do të kishe arritur në atë pikë sa të hedhësh baltë mbi emrin tim e gruas time duke na hequr të drejtën për të qenë prindër, duke na hequr te drejtën për të parë vajzën tonë, duke kërkuar pa asnjë tagër ligjor largimin tonë nga Shqipëria dhe duke na hequr të drejtën për të shpëtuar vajzën tonë.



2. Unë nuk jam në Shqipëri që të sulmoj MEK-un por jam këtu që të liroj vajzën time nga kulti terrorist-xhihadist i MEK-it. Dua ta shpëtoj vajzën time nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi. Dua ta shpëtoj Somayen nga ferri i Manzës dhe ta çoj në lirinë e Kanadasë. Në asnjë rast nuk kam dashur të çoj vajzën time në Iran e as më intereson çfarë bëni ju politikisht. Unë jam larguar nga Irani si azilant politik. Po të shohësh pasaportën time kanadeze që MEK e ka, aty edhe shtetësia edhe kombësia ime shënon kanadez. Marrja e një vize nga Irani për të hyrë në Irak në një kohë që unë isha atje nuk më bën asgjë dhe as nuk më bën mua më pak prind dhe as më heq të drejtën për të qenë baba i Somayehs. Ti si avokate duhet ta dish këtë që viza nuk tregon asgjë, por përkundrazi ti je bërë palë me ish-terroristët dhe shpif së bashku me këtë grup. Si juriste që je a mund të shpjegosh ligjërisht se çfarë tagre ka ky grup radikal mbi vajzën time? Pse duhet të ndërhyjnë këta në marrëdhënien tonë prind-fëmijë dhe ta mbajnë vajzën time peng? Pse duhet unë të komunikoj nëpërmjet medias me vajzën time? Çfarë garancie kam unë që vajza ime nuk torturohet apo dhunohet psikologjikisht nga ky grup, siç më tregojnë muxhahedinët e arratisur nga MEK-u? Pse në asnjë rast ju nuk tregoni arsyen pse unë nga mbështetës i MEK-ut u ktheva në personin që doja të largoja fëmijët e mi prej këtij grupi? Ti si avokate duhet të dish që djali im qëndroi 5 vjet në MEK dhe është dëshmitar i të gjitha vuajtjeve që bëhen aty brenda.

3. Komandantët xhihadistë Behzad Saffari, Jila Deyhim, Ahmad Taba etj, të cilët mbajnë peng vajzën time, drejtuan bandat që më rrahën mua në korrik në Tiranë dhe i kanë duart e përlyera me gjak dhe vrasje në Irak, Iran etj., një ditë, herët apo vonë do të përballen me drejtësinë sikur u përball Sadam Huseini dhe Sllobodan Millosheviçi. Nëse ata nuk përballen me drejtësinë në Shqipëri, do të përballen me drejtësinë në gjykatat evropiane.

4. Komandant Behzad Saffari, xhihadisti, i cili ndoshta të ka shkruar ty letrën propagandistike që ti ke firmosur kundër meje, është një nga personat kyç në rrëmbimin, abuzimin dhe presionin psikologjik ndaj vajzës sime. Presioni dhe shantazhi i tij kundër vajzës sime sikur dëshmohet edhe nga burimet kanadaze, një ditë do të përballet me ligjin. Behzad Saffari, i cili drejton ofensivën e MEK-ut në Shqipëri dhe u bën presion mediave që të mos publikojnë akuzat kundër MEK-ut nën justifikimin se "nëse bëni këtë do na vrasi Irani" është të personi që më ka torturuar djalin tim, Mohamadin në Irak, duke ma burgosur në kontenierë në shkretëtirë, dhe ai është personi kyç që mban peng vajzën time në Manzë. Herët apo vonë Behzad Saffari do të përballet me drejtësinë dhe pengmarrja që ai i bën vajzës sime një ditë do të ndëshkohet nga ligji ose në Shqipëri ose në Evropë.

5. Vajza ime Somayeh Mohammadi është peng i organizatës terroriste MEK. Letrat që ajo shkruan, nuk janë shkruar nga ajo, por nga komandantët muxhahedinë që e mban peng në kampin e Manzës. Komanda xhihadiste e MEK-ut nuk e lë vajzën time të lirë, por e mban të mbyllur në kamp, pse ata kanë frikë se nëse Somayeh takon prindërit e saj dhe lihet e lirë, ajo do publikojë krimet që MEK-u ka bërë me atë. Letrat që MEK-u boton në emër të saj, janë letra që i bën vetë MEK-u. MEK-u dhe xhihadistët sikur Behzad Saffari janë aq të trembur nga vajza ime, sa që nuk e lënë merhumen që të dali jashtë kampit xhihadist të Manzës dhe të takohet me prindërit e saj apo gazetarët, pse nuk i besojnë Somayes në liri. Për këtë arsye MEK-u ka sulmuar dhe rrahur e fyer në javët e fundit mediat dhe gazetarët shqiptarë, britanikë etj. që kanë shkuar në kampin e Manzës për të takuar Somayen. MEK-u nuk guxon në asnjë moment që të lërë Somayehn e lirë. Për këtë arsye ata ndoshta ta kanë shkruar edhe ty letrën që ti ke firmosur kundër nesh. Ata duan të trembin opinionin publik dhe drejtësinë që ata të mos kenë akses me një Somayeh të lirë, e cila nuk jeton nën presionin konstant të xhihadistëve të MEK-ut. Somayeh është aq e lirë sa ishin të lirë edhe pengjet e ISIS-it kur dilnin para kamerave dhe lavdëronin ISIS-in me pistoletën në kokë. Dhe ju znj. Kola e dini shumë mirë këtë.

Komandant Behzad Saffari nuk e fal kurrë Somayen dhe nuk e lë kurrë të lirë, pasi në vitin 2004 kur ajo u intervistua nga autoritetet kanadeze ajo shprehu dëshirën për t'u larguar nga MEK-u. Por sikur tregohet në raportet kanadeze (lexo shkrimet e Steuart Bell te shqiptarja.com), ajo u shantazhua nga Behzad Saffari në prezencë të zyrtarëve kanadezë dhe ajo jeton nën terrorin psikologjik të këtij muxhahidini të frikshëm.

6. Znj. Margarita Kola, Ne prindërit e Somayehs duam që vajza jonë të jetojë e lirë sikur ju. Të vishet si të dojë ajo. Të dali në kafe sikur ju. Po të dojë, të hapi agjenci martesore sikur ju. Të martohet, ketë familje, shok dhe shoqëri sikur ju. Nëse ju mendoni se vajza jonë është e lumtur me jetën që ajo bën, ne u sugjerojmë që të ndërroni rolet me vajzën tonë. Shkoni në Manzë dhe bëhuni xhihadiste, vishuni me uniformë ushtarake dhe jetoni në mes të vapës në kampin ushtarak të MEK-ut dhe trushpëlahuni për të bërë xhihad me Iranin. Si shkëmbin bindeni Behzad Saffarin që të lirojë vajzën tonë dhe ajo të bëjë jetën e lirë që ju bëni në Tiranë.

Kuptohet që komanda e MEK-ut nuk do lejojë kurrë një gjë të këtillë. Behzad Saffari nuk të pranon ty si xhihadiste në Manzë, pasi ti nuk i plotëson normat e tyre.

Ne i lutemi autoriteteve shqiptare që të sigurojnë jetën e vajzës sonë, e cila mbahet peng nga MEK-u, pasi ne e dimë se nëse një ditë vajza jonë do jetë pranë lirisë, MEK-u do bëj gjithçka që ajo të mos jetojë më.

Somayeh di shumë sekrete të MEK-ut. Për këtë arsye ajo mbahet në izolim në kampin xhihadist të Manzës.

Por ne prindërit e saj premtojmë se nuk do ndalojmë kurrë betejën tonë ligjore për të çliruar vajzën tonë nga organizata ish-terroriste e MEK-ut.

## Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Bëjnë arte me re.
2. Krijoi Arsene Lupin (inic).
3. Janë forma.
10. Në hyrje të plazhit.
11. Kapen të parat.
13. Janë ufot.
14. Mbahen nga ata që i thyejnë.
18. Inicialet e Mascagni-t.
19. Në krye të trupave.
20. Eshtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
22. Pak hemorragji.
23. U shkrua nga Jack London.
25. Institucione Ndërkombëtare Europiane.
26. Scarlet e Bashkë me erën.
27. Janë tituj në ekran.
29. Eric aktor.
31. Kështu e ka syrin vigjilenti
32. Janë nofka.
35. Një provë... inteligjence.
37. Mund të jenë me sahat.
38. Një pjesë e naivitetit.
40. Pak imagjinatë.
42. Pikat pa kufij
43. Fillojnë aksionin.
44. Kërkohet nga poetët.
47. Nota e diapazonit.
48. I prin kolonës.
51. Eshtë filozofie moralit.
52. Ulet në dhomën e lartë.

VERTIKAL

1. Malet pa kufij.
2. Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
4. Inicialet e Altman.
5. Një sportist që arrin majat
6. Courier ish-kampion i tenisit.
7. Fillojnë testin.
8. Mund të jetë parabolike.
9. Bie me ballë.
10. Carnera, ish-kampion i ringut.
11. Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënsit
12. I kanë rrënjët në tokë.
15. Eshtë pushkë.
16. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
17. Takim Brezash Durrës.
21. Ishte lumi i Elizit
22. Eshtë kardinal.
24. Mbyllin një krah.
28. Artikull anglez.
30. Mbyllin fushatat.
31. Partia pa ara.
32. Zola që shkroi Nana
33. Nganjëherë duhen vënë mbi i.
34. Një fjalë kastile
36. Inicialet e Mann shkrimtar.
39. Maiden që këndojnë.
41. Ai i shtatë është kinemaja.
43. Fillojnë arsyetimin.
45. Eshtë nënë e Tironës.
46. Eshtë shahu i fundit.
48. Inicialet e Klee piktor.
49. Dy asa.
50. Mbarojnë fare

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL:
1. Patricia këngëtare.
5. I vocërr ai i Migjenit
9. Hari spiune.
12. Qyteti i Robespierre.
14. Phineas i famshëm i cirkut.
16. Pak latinisht.
17. Inicilet e Banderas.
19. Janë tek në rrota.
20. Pak efikasitet.
22. Eshtë shkolla fillore.
24. Arrihet duke aderuar
27. Pak iniciativë.
28. Një... art i Don Judd.
29. U kompozua nga Rachmaninov.
31. Diku në qendër.
32. Një është për të lidhur.
33. Jepet për hartim.
35. Sergej, poet i famshëm rus.
37. Veriu pa kufij.
39. Mbyllin një tender.
41. Një pjesë analogjisë.
42. Mjeku pa ju.
43. Nisin nga kreu.
44. Një racë kombi.
46. Një rapper i famshëm.
49. Një pikë... vaji.
50. Në fund majtas.
51. Ndizen me një çelës.
53. Emri i Delon
54. Janë të dërguar specialë

VERETIKAL

1. Eshtë edhe ai i sheqerit.
2. Eshtë lloj papagalli.
3. Një Pop i Andy Warhol.
4. Sapo fillojnë.
6. Qendër në Kubë.
7. Eshtë pluhuri si Dash.
8. Eshtë e hollë dhe therëse.
9. Fillojnë muzikën.
10. Një kontinent i ri.
11. Eshtë për medaljen e parë.
13. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve.
15. Provinca e boerëve.
18. Eshtë qyteti i njëmbinjë dritareve.
21. Eshtë dukuria.
22. Eshtë hidrokarbur.
23. Griffith aktore.
25. Qe perëndesha e fitores.
26. Mbeten në fund.
30. Tregon çmimin.
34. Këndohet në opera.
36. Para Fe në New Mexico.
37. Eshtë princ arab.
38. Tony që këndon Quando, quando, quando.
40. Bën mëza.
45. Pak tolerante.
47. Modem pa zë.
48. Pak marramendëse.
50. Mbyllin një dyqan.
52. Fillojnë teorikisht.



## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 7 | | | | | 9 | |
| 3 | | 9 | | | | | 2 | 8 |
| | 4 | | | | | | | 7 |
| | 5 | | | 7 | | 3 | | |
| | 7 | | 1 | | | | | 2 |
| | | 8 | | | 3 | | | 1 |
| | | | 4 | | | | | |
| 5 | 6 | 4 | 7 | | 1 | | | |
| | | | 3 | 9 | | 2 | 5 | |

### Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | 2 | 8 | 7 | 5 | 9 | 4 | 6 | 1 |
| 4 | 1 | 9 | 3 | 6 | 8 | 7 | 2 | 5 |
| 5 | 6 | 7 | 4 | 1 | 2 | 3 | 8 | 9 |
| 9 | 4 | 5 | 1 | 2 | 6 | 8 | 3 | 7 |
| 1 | 3 | 2 | 8 | 7 | 5 | 9 | 4 | 6 |
| 7 | 8 | 6 | 9 | 3 | 4 | 1 | 5 | 2 |
| 8 | 5 | 1 | 6 | 4 | 7 | 2 | 9 | 3 |
| 2 | 7 | 4 | 5 | 9 | 3 | 6 | 1 | 8 |
| 6 | 9 | 3 | 2 | 8 | 1 | 5 | 7 | 4 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## Argëtim filozofik

- Njeriu mund të ndalet duke u ngjitur, por jo kur bie.

- Njerëzit më të shkolluar nuk janë edhe më të mençurit.

- Ne nuk i konsiderojmë kafshët si qenie morale. Por mos vallë mendoni se ne kafshët na mbajnë për qenie morale?

- Ju vuani dhe kërkoni që ne të jemi zemërbutë ndaj jush, në një kohë që vuajtja juaj ju bën të jeni të padrejtë kundrejt gjërave dhe njerëzve.

## KRIPTOSKEME



## KRIPTOSKEME

*Përgjigja e numrit të djeshëm*

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| R | A | S | T | E | T | | P | A | | | P |
| U | R | A | T | | U | | R | | H | P | A |
| S | A | M | | M | | M | A | R | A | I | S |
| I | | A | M | E | R | I | K | A | N | E | T |
| | P | R | O | T | E | S | T | A | N | T | E |
| G | J | I | G | A | N | T | I | | I | R | U |
| B | E | T | O | N | | E | K | | B | O | R |
| | S | A | L | I | | R | A | M | A | | |
| T | O | N | | | T | I | T | U | L | L | I |
| A | R | E | S | | A | O | | | | E | R |
| P | J | | A | R | | Z | O | T | I | M | I |
| A | A | | M | E | R | E | N | G | U | E | S |



## Thënie të mençura

- Janë njësoj të parrezikshëm, njerëzit e mençur dhe budallenjtë. Të rrezikshëm janë vetëm gjysmë të marrët dhe gjysmë të mençurit.
- Mikun, të cilit nuk mund t'ia përmbushësh shpresat, më mirë uro që ta kesh armik.
- Të jeni pronar i vullnetit tuaj dhe shërbëtori i ndërgjegjes tuaj.
- Dhurata më e madhe është pasioni për leximin.
- Një nga përdorimet më të këqija të kohës, është të bësh diçka shumë mirë që nuk është e nevojshme të bëhet.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al